

magazina. evropiane

Politika e jashtme

SOROS

Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo
Kosovo Foundation for Open Society

| Dhjetor 2012 | Numri 7 |

politika e jashtme politika e jashtme politika e jashtme politika e jashtme politika
e jashtme politika e jashtme politika e jashtme politika e jashtme politika
**NEW
BORN**
politika e jashtme politika e jashtme politika e jashtme politika e jashtme politika

HYRJE

Magazina Evropiane, revistë e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur ka tashmë disa vite që vazhdimisht begaton diskursin publik e politik. Shkrimet e prezantuara në numrat e kaluar kanë shtjelluar tema të përqendruara në një grup politikash sektoriale dhe si të tilla kanë avancuar debatin mbi proceset integruese. Ky debat është pasuruar me analiza të reja mbi sektorin e adresuar, apo me prezantim të përvojave të shteteve tjera, tashmë anëtare të Bashkimit Evropian. Si e tillë, magazina ka shërbyer si mjet i vlefshëm në ndërtim të njohurive sektoriale, në masën më të gjerë, mbi sfidat dhe efektet e procesit evropianizues.

Përderisa temat e kaluara kanë qenë drejtpërdrejtë të lidhura me politikat evropiane dhe proceset integruese, kësaj radhë, kemi vendosur të ju sjellim një edicion me tematikë më të gjerë, si ajo e politikës së jashtme. Në mungesë të një publikimi Kosovar periodik i cili do të informonte mbi zhvillimet e politikës botërore, do të analizonte efektet e tyre në politikën e jashtme kosovare, dhe në përgjithësi do të ngrit në nivel më të lartë debatin publik në Kosovë mbi politikën e jashtme, Fondacioni ka vendosur që numrin e radhës të Magazinës t'ia dedikojë mu kësaj teme, asaj të politikës së jashtme.

Një tematikë e tillë nuk nënkupton devijim nga diskursi i mëhershëm evropian i Magazinës, në të kundërt. Artikujt e shkruar nga autorë të shquar kosovar demonstrjnë se një pjesë e konsiderueshme e politikës së jashtme të Kosovës ka të bëjë me Bashkimin Evropian, ja pse

Promovuesit e transformimit pro-evropian, mundohen ta theksojnë shpesh se procesi i integritimit evropian është teknik, më shumë se sa politik, dhe se varet kryekëput nga performanca e shtetit aderues. Përvojat e Kosovës me Bashkimin Evropian na bëjnë me dije se në fakt ky proces ka komponentë politike shumë më të fuqishme se sa ato teknike, e që rezultojnë nga mos-njohja e pesë anëtareve të saj. Në mungesë të unitetit vetanak që do të i mundësonte Kosovës zbarkimin në politikat e rregullta të zgjerimit të Bashkimit Evropian, kjo e fundit tashmë sa kohë vjen me modalitete të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit, çfarë ishin së pari Mekanizmin Përcjellës i Stabilizim Asocimit, Dialogu aktual i procesit të Stabilizim Asocimit, e brenda tij edhe dialogu mbi sundimin e ligjit, fillimisht dialogu për liberalizimin e vizave, etj.

Natyra e këtij relacioni thekson dy kahje të politikës së jashtme aktuale të Kosovës. Përderisa në njërën anë prioritet i padiskutueshëm është sigurimi i njohjeve të reja, në anën tjetër, domosdoshmërisht theksohet nevoja e përafrimit me 5-shen



që nuk e ka njohur shtetësinë e Kosovës në mënyrë që të na mundësohet rrugëtimi tradicional, në vend të sui generis, drejtë anëtarësisë në BE.

Natyra e këtij relacioni ka shtyrë shumë autorë që në kuadër të politikës së jashtme të Kosovës t'i japin hapësirë analizës së marrëdhënieve mes Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Megjithatë, ky edicion sjell edhe artikuj mbi aspekte tjera të politikës së jashtme dhe ofron analiza mbi marrëdhëniet e mundshme me shtetet që nuk e kanë njohur shtetësinë e Kosovës, mbi qasjen globale që mund ta marrë politika e jashtme e Kosovës, e po ashtu edhe mbi rolin që merr diplomacia kulturore në ndërtimin e imazhit të ri të vendit tonë. Me këtë shpresojmë që Magazina Evropiane të ketë arritur të ju inspirojë për qasje të reja drejtë sfidave të vjetra e po ashtu ta begatojë diskutimin publik mbi politikën e jashtme kosovare.

Prandaj ju ftojmë të lexoni materialin që ju prezantojmë në këtë numër dhe të konstruktujmë më tutje debatin, e pse jo, edhe praktikën e politikës sonë të jashtme.

Lexim të këndshëm.

Iliriana Kaçaniku
Koordinatorë e programit për Integrim Evropian
dhe Qeverisje të Mirë
Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur

NË KËTË NUMËR

POLITIKA E JASHTME

E ARDHMJA E RAPORTEVE TË
KOSOVËS ME BE PAS STUDIMIT
TË FIZIBILITETIT

Augustin Palokaj

Faqe 4

RRUGA E KOSOVËS DREJT BASHKIMIT
EVROPIAN

Enver Hoxhaj

Faqe 6

REBUSI I INTEGRIMIT TË KOSOVËS NË
BE DHE PESË VENDET ANËTARE QË
NUK E KANË NJOHUR PAVARËSINË

Lulzim Peci

Faqe 8

A KA ÇFARË T'I SJELLË KOSOVA BE-SË?

Iir Dugolli

Faqe 11

VEPRIMI I RIMARRJES: SI T'IU
NDIHMOMET SERBISË DHE KOSOVËS
TË ECIN DREJT BE-SË?

Jordi Vaquer i Fanes
dhe Cristian Ghinea

Faqe 13

KOSOVA DHE BE-JA, TË LUFTUARIT
PËR NJË MARRËDHËNIE NË KRIZË

Oana Popescu

Faqe 19

SPANJA DHE KOSOVA: HAPAT PËR
NJË NJOHJE NË TË ARDHMEN NË KORNIZË
TË INTEGRIMIT EVROPIAN

Ruth Ferrero-Turrión

Faqe 23



POLITIKA E JASHTME E KOSOVËS

Tim Judah

Faqe 26

DIPLOMACIA EVOLUESE E KOSOVES
Petrit Selimi

Faqe 29

TË MËSOSH NGA ASTERIKSI (YLLI) PËR
TË ARDHMEN E NDRITSHME TË NJË
FUSNOTE

Ulrike Lunaçek

Faqe 31

NEGOCIATAT: NJË RAST I HUMBUR

Veton Surroi

Faqe 35

ORA E DIPLOMACISË PRISHTINASE...

Eliza Hoxha

Faqe 37

politika e jashtme

E ARDHMJA E RAPORTEVE TË KOSOVËS ME BE PAS STUDIMIT TË FIZIBILITETIT

Augustin Palokaj

nëntor 2012



foto: Jetmir Idrizi

Raportet e komplikuar të Bashkimit Evropian me Kosovën, si pasojë e mospajtimeve brenda BE-së rreth statusit të sajë por edhe të zhvillimeve të brendshme në këtë shtet, kanë hyrë në një fazë të re gjatë vjeshtës së këtij viti kur Komisioni Evropian ka nxjerrë një Studim fizibiliteti për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (SAA).

Ky studim dhe puna që kanë bërë nëpunësit e Komisionit Evropian kanë tërhequr fokusin e vëmendjes si në Kosovë ashtu edhe në BE.

Duke pasur parasysh se dialogu mes Prishtinës dhe Beogradit ishte pezulluar për kohësisht për shkak të zgjedhjeve në Serbi, dhe për faktin se Serbia ka arritur tashmë të fitoj statusin e kandidatit për anëtarësim në BE, ky studim paraqet pothuajse të vetmin aktivitet në të cilin BE është angazhuar rreth Kosovës. Ky studim është pritur me shumë kureshtje por rreth tij ende kanë mbetur shumë paqartësi. Më lehtë është që në fillim të përmenden gjërat të cilat dihen.

Dihej se ky studim do të nxirret në muajin tetor. Dihej po ashtu se këtë vit nuk do të ketë një raport individual të progresit për Kosovën sepse „studimi i fizibilitetit“ përfshinë edhe elementet të cilat zakonisht janë në një raport progresi. Dihej po ashtu se ky „studim“ nuk i obligon në asnjë mënyrë ligjore vendet anëtare të BE-së pos që u bën një obligim politik. Dihej dhe pyetja në të cilën në konkluzione do të duhej të përgjigjej dhe të jep rekomandime Komisioni Evropian me këtë „studim“: „A është fizibile (e realizueshme) që Kosova të nis me BE-në negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit?“

Ishte e qartë se në rastin e Kosovës nuk do të jetë lehtë të gjendet një përgjigje në këtë pyetje.

Po të insistoj që Kosova të trajtohet njëloj sikur të gjitha shtetet e rajonit të Ballkanit përgjigja në këtë pyetje do të ishte negative. Komisioni do të kishte ardhur në përfundimin se „nuk ka baza ligjore që në mes të Bashkimit Evropian dhe vendeve të saja anëtare në njërin anë dhe Kosovës në anën tjetër të nënshkruhet një Marrëveshje Stabilizim Asociimi“ dhe kjo do të arsyetohej me faktin se 5 shtetet nuk e njohin Kosovën si shtet dhe nuk duan të kenë marrëdhënie kontraktuale me Kosovën.

Marrëveshja SA pos që ka fuqinë e marrëveshjeve Kontraktuale me „Bashkimin Evropian“ ka fuqinë edhe të raporteve kontraktuale mes të gjitha shteteve nënshkruese (në rastin e Kosovës do të ishin 27 shtete të BE-së plus Kosova) në parlamentet e të cilave do të duhej dhe të ratifikohet një Marrëveshje e tillë.

Por Komisioni Evropian beson se ka gjetur formulën që të ec përpara në rastin e Kosovës duke ardhur në përfundim se është e mundur të arrihet një Marrëveshje SA me Kosovën duke mos paragjykuar pozicionin e shteteve anëtare rreth statusit. Kjo është bazuar në opinionin e ekspertëve ligjorë të cilët janë thirrur në disa pjesë të Traktatit mbi Funksionimin e Unionit Evropian e që i mundësojnë Përfaqësueses së lartë ose Komisionit Evropian të arrin marrëveshje ndërkombëtare me „entitete që nuk janë shtete sovranë“. Pritet që ta pranoj si fakt se Kosova nuk mund të ketë të njëjtën formë të Marrëveshjes SA sikur të gjitha vendet tjera të rajonit dhe do të mund të sugjeroj një formë „hibride“ të arritjes së një Marrëveshjeje mes Kosovës dhe BE-së. Është e qartë se Komisioni këtu ka shfrytëzuar mjeshtëritë e ekspertëve juridikë të BE-së për të gjetur formulë magjike që do të mundësonte një

marrëveshje të tillë me Kosovën pa pasur nevojë që ta nënshkruajnë të gjitha vendet anëtare të BE-së. Në këtë mënyrë një rekomandim i tillë është prezantuar si një sukses i madh për të gjithë; Kosovën nuk e len tërësisht jashtë proceseve të përafritit (fjala „përafrit“ këtu përdoret qëllimisht në vend të fjalës „integrit“) me BE-në, do ta bënte të mundshme një „Marrëveshje“ të rëndësishme ndërsa për Serbinë dhe 5 vendet e BE-së të cilat nuk e kanë njohur Kosovën porosia është se „Kosova dallon nga shtetet tjera“.

Edhe në vet Konkluzionet e Këshillit të Bashkimit Evropian, dhe aneksit në to nga ana e Komisionit, është bërë e qartë se „studimi i fizibilitetit“ do të bëhet pa paragjykuar statusin legal të Kosovës dhe pa paragjykuar çfarëdo vendimi të Këshillit.

Pos gjetjes së mundësive ligjore për një Marrëveshje SA mes Kosovës dhe BE-së (ku sfida ekziston më shumë në anën e BE-së sesa të Kosovës) pjesa më e madhe e studimit të fizibilitetit është rreth gatishmërisë së vet Kosovës për të nisur dhe arritur një marrëveshje SAA me BE-në.

Këtu Komisioni Evropian ka përdorur metodologjinë e njëjtë sikur për shtetet tjera të rajonit. Dhe këtu ishte e qartë se, nëse përdoren të njëjtat kritere, Kosova rrezikonte që të mos merr tërësisht notën pozitive. Dihej se pos analizës së bazës ligjore të Kosovës Komisioni do të mat edhe kapacitetet implementuese të Kosovës në të gjitha nivelet e administratës publike. Kjo solli deri tek situata ku Komisioni nuk qe në gjendje të rekomandoj nisjen e negociatave për një MSA por caktoj disa kushte të cilat Kosova duhet ti përmbush para se të mund të merret vendimi.



Duke marrë parasysh se as në pyetjen rreth bazës ligjore brenda BE-së për të arritur Marrëveshje SA me Kosovën dhe as në pyetjen se a është Kosova e gatshme për një Marrëveshje të tillë nuk pati një përgjigje e prerë atëherë edhe ndodhi që edhe ky „studim i fizibilitetit“, aq i prituri, të shëndrohet në fund në një lloj „stimulimi për Kosovën“ në formën e një rekomandimi të kushtëzuar se „Kosova do të mund të nis procesin e Marrëveshjes SA kur të përbushë kushtet e mbetura“.

Por ekziston edhe këndi politik i këtij „studimi të fizibilitetit“ dhe ai, përkundër insistimit të BE-së se „gjithçka varët krejtësisht nga meritat individuale të secilit vend në rajon“ në masë të madhe determinoi edhe porosinë nga Studimi. Vet nisja e studimit të fizibilitetit ishte bërë edhe për të krijuar përshtypjen se në kohën kur Serbisë i jepet statusi i kandidatit (që është vendim historikë në raportet e një vendi aspirantë me BE-në), dhe kjo si rezultat i disa marrëveshjeve në dialog me Kosovën, duhet t'i jepet një shpërblim edhe Kosovës. Studimin e Fizibilitetit e kanë quajtur si „pjesë të një pakoje të shpërblimeve“ edhe vet zyrtarët e lartë të Kosovës përfshirë Kryeministrin Hashim Thaçi dhe të dërguarën e tij të posaçme për dialog Edita Tahirin. Edhe Komisioneri i zgjerimit të BE-së Stefan Fule, kur priste dhënien e statusit të kandidatit Serbisë, qartë pat thënë se „Serbia dhe Kosova ose do të dështojnë së bashku ose do të përfitojnë së bashku“ me çka bëri të qartë se raportet mes tyre janë kusht për rrugëtimin drejt BE-së, natyrisht me një hendek të madh në fazat në këtë proces në favor të Serbisë dhe ngecje të Kosovës.

Kështu edhe në përmbajtje dhe në rekomandime Studimi i Fizibilitetit përmban edhe elementin politik. Në këtë mënyrë Bashkimi Evropian mban edhe Kosovën të lidhur si pengë të dialogut me Serbinë dhe mund të kushtëzojë lëvizjet e ardhshme të Kosovës drejt BE-së me marrëveshjet që Kosova duhet t'i arrin me Serbinë. Në anën tjetër të njëjtën vegël BE-ja do ta përdorë edhe për Serbinë por për një shkallë shumë më të lartë në ngritjen kah integrimi në BE, për datën e nisjes së negociatave. Kjo ishte edhe arsyeja pse sapo u formua qeveria e re në Serbi BE-ja nuk e pati të vështirë që t'i ulë Prishtinën dhe qeverinë e porsazgjedhur në Serbi të ulën në tryezën e dialogut përsëri dhe të nxjerr nga to „sjellje konstruktive“.

Nëse gjërat do të shkonin sipas planit dëshira në Bruksel ishte që me pakon e strategjisë së zgjerimit në vjeshtë Komisioni Evropian të rekomandojë nisjen e negociatave të anëtarësimit me Serbinë dhe nisjen e procesit të arritjes së një Marrëveshje SA me Kosovën. Në Komisionin Evropian qartë vërehet një qëllim i tillë, natyrisht nëse Serbia dhe Kosova përbushin kriteret minimale. Por entuziazmin e njëjtë nuk e ndajnë edhe vendet anëtare të BE-së të cilat në fund e kanë të drejtën që të marrin vendimin formalë. Komisioni ishte optimist por fakti se shumica e marrëveshjeve të arritura nuk u zbatuan ajo nuk që në gjendje të rekomandojë as nisjen e negociatave me Serbinë.

Edhe por të propozonte Komisioni datën e nisjes së negociatave të anëtarësimit me Serbinë dhe nisjen e procesit për Marrëveshjen SA për Kosovën Këshilli i BE-së do ta kishte të vështirë që të arrij konsensus për këtë.

Problemi për Serbinë qëndron në sjelljen destruktive në rastin e Kosovës prej kur ka marrë statusin e kandidatit. Arrestimi i shtetasve të Kosovës në mënyrë arbitrare, mosnënshkrimi i marrëveshjes së arritur në dialog dhe zbatimi tepër i vogël i tyre nga ana e Serbia i kanë dëmtuar seriozisht gjasat e Beogradit që të merr në fund të këtij viti datën për negociatave. Ky dëm, thonë në Bruksel, do të kërkojë kohë që të riparohet nga ana e Beogradit.

Për Kosovën komplikimet ishin edhe më të mëdha, duke filluar nga vet fakti se në pjesën e dytë të vitit 2012 kryesimin e radhës së BE-së e pati Qiproja e cila jo vetëm se nuk e njeh Kosovën por është e vetmja në BE që refuzon të ketë çfarëdo kontakti me përfaqësues të sajë. Kjo sfidë disi u tejkalua pasi Qipro gjatë presidencës së saj ndoqi politikën e përbashkët të BE-së e jo vetëm qëndrimin nacional. Por janë edhe shtetet tjera të cilat nuk duan që BE-ja të bëjë asnjë hap në raportet me Kosovën i cili do të mund të kuptohet në çfarëdo mënyrë se Kosova po trajtohet si shtet i pavarur.

Problem tjetër për Kosovën i cili pati ndikim negativ në Studimin e fizibilitetit është performanca jo e mirë e autoriteteve vendore në luftë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, vonesat në arritjen e reformave zgjedhore, tentimet e imponimit të ligjeve të cilat shihen si presion ndaj lirisë së mediave dhe shumë mangësi tjera të cilat i adresoj në studimin vet Komisioni Evropian.

Duke pasur parasysh të gjitha këto ishte e pritshme që pas „Studimit të Fizibilitetit“ Kosova në raportet me Bashkimin Evropian të hyj vërtetë në një fazë të re por ajo fazë mund të jetë një lloj „status quo-je“ e re. Çështja e trajtimit të Kosovës si shtet të pavarur apo jo do të vazhdojë edhe me vite të rëndoj dhe komplikoj raportet e Kosovës me Bashkimin Evropian sepse pa pasur mundësi ligjore që ta trajtoj Kosovën si shtet të pavarur Bashkimi Evropian e ka të pamundur të arrij raporte të mirëfillta kontraktuale me të, se paku jo të njëjta siç i ka me shtetet tjera të rajonit. Dhe, ajo që është vlera më e madhe e Marrëveshjes SA, hapja e rrugës drejt anëtarësimit të plotë në BE përmes marrjes së statusit të kandidatit dhe nisjes së negociatave të anëtarësimit, për Kosovën do të mbetet edhe pas këtij studimi një mundësi afatgjatë për një kohë të pacaktuar në të ardhmen.

RRUGA E KOSOVËS DREJT BASHKIMIT EVROPIAN

Enver Hoxhaj
prill 2012



foto: Jetmir Idrizi

Hyrje

Kur Komisari për Zgjerim dhe Politika Evropiane të Fqinjësisë, Shtefan Füle, shpalli fillimin e studimit të fizibilitetit për Marrëveshjen për Stabilizim dhe Asociimit me Kosovën në mars, kosovarët kremtuan njohjen e ekzistencës së vendit tonë brenda kontinentit evropian dhe përfshirjen aty. Në vitin tonë të katërt të ekzistimit si shtet i pavarur, kjo paraqet një lëvizje të re të rëndësishme në marrëdhëniet BE-Kosovë. Pas të gjithave, tashmë një kohë të gjatë kosovarët kanë aspiruar që të jenë pjesë e Bashkimit Evropian dhe e katër lirive të tij: lëvizjes së mallrave, të shërbimeve, të njerëzve dhe të parave.

Shoqëria e Kosovës dhe udhëheqja e saj janë të bashkuar në synimin e tyre drejt integritimit në Bashkimin Evropian. Kosova shpalli pavarësinë e saj më 17 shkurt 2008 dhe është njohur nga 89 shtete anembanë globit. Gjatë më tepër se një dekade të reformave të mëdha dhe bartjes së kompetencave, në qendër të vëmendjes dhe të përpjekjeve të institucioneve të Kosovës kanë qenë proceset e integritimit në BE. Në të vërtetë, aspiratë e popullit dhe e qeverisë së Kosovës është të jenë pjesë Bashkimit Evropian dhe e zonës Shengen që do t'ua mundësonte atyre të udhëtojnë pa viza dhe të angazhohen në aktivitete tregtare me shtetet anëtare të Bashkimit Evropian.

Madje edhe pa e pasur një qëndrim të unifikuar, BE-ja është aktivisht e angazhuar në Kosovë. Që nga viti 1999, BE ka luajtur një rol të rëndësishëm në

përpjekjet e bashkësisë ndërkombëtare për ta ndërtuar një të ardhme evropiane për Kosovën. Me një përfaqësi në Kosovë dhe duke ofruar më shumë se 2 miliardë € ndihmë, mbështetja e politikave është hartuar në mënyrë të kujdesshme që t'iu përgjigjet nevojave tona në faza të ndryshme të zhvillimit të Kosovës pas konfliktit.

Studimi i fizibilitetit dhe përpjekja e Kosovës

2012 është një vit ambicioz për Kosovën. Jemi angazhuar në një agjendë intensive të BE-së që do të na sjellë më afër procesit të integritimit në Bashkimin Evropian. Ne presim që të kemi sukses në sigurimin e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës, në marrëdhëniet tregtare dhe në ndihmën e mëtejshme nga programet e BE-së. Në lidhje me liberalizimin e vizave, procesi tashmë ka filluar me vizitën e Komisares Malmström në Kosovë në janar. Ne presim që ta marrim udhërrëfyesin në fillim të verës. Marrëdhëniet tregtare dhe përfitimi i ndihmës shtesë janë çështje të lidhura ngushtë me studimin e fizibilitetit për Marrëveshjen për Stabilizim dhe Asociim.

Shtetet tona fqinje e kanë ndjekur rrugën e ngjashme. Ka qenë inkurajuese për ne kur e kemi parë realizimin e reformave nga vendet që më parë kanë qenë vende që kanë aspiruar hyrjen në BE të cilat janë mbështetur përmes fondeve të BE-së për reforma dhe zhvillim. Mezi presim të bashkëpunojmë ngushtë me BE-në po ashtu.

Studimi i fizibilitetit do t'i vlerësojë elementet në aspektin politik, ekonomik dhe juridik. Vlerësimi do të shërbejë si referencë për hapat e kërkuar për të biseduar dhe për ta zbatuar Marrëveshjen për Stabilizim dhe Asociim me BE-në. Tregtia është në veçanti vendimtare për studimin e fizibilitetit në Kosovë. Adresimi i çështjeve kryesore siç është administrata publike, sundimi i ligjit, mbrojtja e të gjitha komuniteteve dhe të drejtat pronësore në Kosovë, janë të gjithë hapa të rëndësishëm në rrugën tonë drejt arritjes së marrëdhënieve kontraktuese me BE-në.

Institucionet kosovare janë duke punuar që t'i përmbushin obligimet evropiane dhe ndërkombëtare. Vlen posaçërisht të përmendet puna e institucioneve të Kosovës për ta siguruar mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të gjithë qytetarëve të Kosovës, me theks të posaçëm ato të komuniteteve jo-shumicë. Ministria jonë për integritet evropian dhe ajo për punë të jashtme janë përqendruar në sigurinë e dokumenteve, në imigrim dhe në menaxhimin e kufijve. Për më tepër, ne jemi të përkushtuar që ta bëjmë një luftë të paepur për ta çrënjësuar krimin e organizuar dhe korrupsionin.

Populli dhe qeveria e Kosovës e kuptojnë nevojën që të jenë partner i BE-së dhe e pranojnë procesin evropian të para-anëtarësimit si shtytës për reformat dhe zhvillimin shumë të nevojshëm në Kosovë dhe në Ballkan. Edhe pse ende mund të jemi me vite larg nga anëtarësimi në BE, ne jemi optimistë që përmes përpjekjeve



tona konkrete dhe të singerta ne kemi qëndrim unik që të ecim përpara në rrugën tonë drejt BE-së.

Në tetor 2011 e kemi pranuar Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën. Si pjesë e pakos së zgjerimit, ku raporti ka rëndësi të madhe për Kosovën. Ai i ka vërtetuar përpjekjet e vazhdueshme në aspektin politik, ekonomik, tregtar, të mjedisit, dhe në aspektet e tjera. Ndërsa ne e pranojmë që duhet të bëhet edhe më shumë, ne jemi siguruar që Kosova ka të ardhme evropiane.

Duke iu përshtatur rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të KB, ne jemi angazhuar në një dialog me Serbinë të lehtësuar nga BE-ja. Gjatë nëntë raundeve të dialogut me Serbinë, ne i kemi mbuluar çështjet

praktike siç është pranimi i diplomave universitare, regjistri civil, dogana, menaxhimi i integruar i kufijve dhe bashkëpunimi dhe përfaqësimi rajonal. Pika e fundit është me rëndësi të posaçme meqë ia mundëson Kosovën të marrë pjesë dhe të flasë në emër të saj në takimet rajonale dhe në nismat për bashkëpunim.

Së fundi Kosova e ka themeluar Këshillin Nacional për Integrim Evropian që ka për qëllim të sigurojë qëndrime të pajtueshme në mbarë spektrin politik dhe të shoqërisë civile në Kosovë. Arritja e perspektivave të përbashkëta në proceset e ndryshme të reformave dhe të integrimit është një element tjetër vendimtar dhe institucionet e Kosovës dhe shoqëria civile janë duke punuar për këtë qëllim.

Përfundim

Vitet pas pavarësisë na kanë ofruar mundësi për ta vendosur vendin tonë në rrugën drejt të ardhmes evropiane. Jemi mirënjohës për mbështetjen— atë financiare dhe të ekspertëve— të cilën e kemi marrë përmes aktorëve të ndryshëm ndërkombëtarë dhe evropianë në Kosovë. Me këtë mbështetje ne kemi ndërtuar një vend që përfaqëson vlerat dhe standardet më të larta evropiane. Ne presim me padurim bashkëpunimin e vazhdueshëm të shkëlqyeshëm me aktorët kryesorë evropianë për të siguruar që procesi i gjatë dhe kompleks i integrimit të jetë i suksesshëm për Kosovën.

Përmes përpjekjeve tona gjithëpërfshirëse në ndërtimin e vendit dhe të reformave të mëdha që pasuan, së bashku me angazhimin tonë të singertë në dialogun teknik me fqinjin tonë, Serbinë, dhe me përpjekjet tona përfshirëse për përshtatjen e politikave tona me standardet më të larta evropiane, ne kemi kultivuar një kulturë të gjithëpërfshirjes dhe të bashkëpunimit duke pasqyruar standardet më të larta evropiane dhe realitetin e botës sonë sot.

(Enver Hoxhaj është Ministër i Punëve të Jashtme i Republikës së Kosovës.)



REBUSI I INTEGRIMIT TË KOSOVËS NË BE DHE PESË VENDET ANËTARE QË NUK E KANË NJOHUR PAVARËSINË

Lulzim Peci
prill 2012



Vendimi i Këshillit të Bashkimit Evropian i 28 shkurtit 2012, për të konfirmuar qëllimin e Komisionit Evropian për fillimin e Studimit të Fizibilitetit për Marrëveshjen për Asocim dhe Stabilizim me Kosovën, i cili u përkrah edhe nga ministrat e jashtëm të pesë vendeve që ende nuk e kanë njohur pavarësinë e vendit tonë, gjegjësisht Greqisë, Qipros, Rumanisë, Sllovakisë dhe Spanjës, hapi rrugën për një perspektivë të prekshme për integrim të Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian.

Rrethanat që bënë të mundur marrjen e këtij vendimi nga Këshilli Evropian, janë rrjedhojë e zhvillimeve politike, drejtimi i të cilave u përcaktua nga Mendimi këshillëdhënës i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në favor të legalitetit të shpalljes së pavarësisë së Republikës të Kosovës, të 22 korrikut 2010. Mendimi i GJND-së hoqi përfundimisht nga tavolina opsionin e kontestimit legal të statusit të Republikës së Kosovës, që shtyhej nga Republika e Serbisë, dhe që asokohe përkrahej edhe nga një pjesë e bashkësisë ndërkombëtare. Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së e 9 shtatorit 2010, morri në dijeni Mendimin këshillëdhënës të GJND-së, përkrahu fillimin e dialogut të lehtësuar nga BE-ja në mes Kosovës dhe Serbisë, qëllimi i të cilit është përmirësimi i bashkëpunimit, arritja e progresit në rrugën drejt Bashkimit Evropian dhe përmirësimi i jetës së qytetarëve. Me këtë rezolutë, OKB-ja praktikisht ia dorëzoi Brukselit përgjegjësinë e normalizimit të marrëdhënieve në mes Kosovës dhe Serbisë, i cili vështirë mund të arrihet pa perspektivë të prekshme të të dyja

vendeve për integrim në Bashkimin Evropian.

Dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë, i lehtësuar nga BE-ja dhe i përkrahur fuqimisht nga SHBA-të filloi një vit më parë, dhe rezultoi me arritjen e gjashtë marrëveshjeve. Arritja e marrëveshjeve për përfaqësimin dhe bashkëpunimin regjional dhe për menaxhim të integruar të kufijve (pikë-kalimeve) më 24 shkurt 2012, ishte substanciale për hapat e mëtutjeshëm të Kosovës dhe Serbisë drejt integriteteve evropiane. Marrëveshja për përfaqësim dhe bashkëpunim rajonal, edhe pse e karakterit të përkohshëm, ishte një kompromis jo i lehtë për të dyja palët. Mirëpo, kjo marrëveshje i siguron Republikës së Kosovës përfaqësimin si subjekt i pavarur dhe sovran në mekanizmat rajonal dhe ato të Bashkimit Evropian. Në anën tjetër, me pranimin e marrëveshjes për menaxhim të integruar të kufijve (pikë-kalimeve), Serbia i pranoi kufijtë e Kosovës, dhe politika e saj për ndarjen e veriut të Kosovës pësoi fiasko. Këto marrëveshje u arritën pas garancive të cilat i morri Prishtina nga Brukseli dhe Washingtoni për fillimin e Studimit të Fizibilitetit për Marrëveshjen për Asocim dhe Stabilizim, dhe kushtëzimeve të Brukselit ndaj Beogradit për dhënien e statusit të kandidatit për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Në këtë kontekst, duhet theksuar se marrëveshjet për Asocim dhe Stabilizim të BE-së nënshkruhen vetëm me vendet e pavarura, dhe përkrahja e fillimit të Studimit të Fizibilitetit edhe nga pesë vendet që nuk e kanë njohur Kosovën,

edepsëz jo pa rezerva, shënon hapjen e një kapitulli të ri të marrëdhënieve në mes Kosovës dhe BE-së. Marrëveshjet për Asocim dhe Stabilizim janë të karakterit "trepalësh", gjegjësisht në mes vendit gjegjës, Këshillit Evropian që duhet ta merr aprovimin e Parlamentit Evropian, dhe vendeve anëtare të Bashkimit Evropian. Hyrja në fuqi e kësaj marrëveshjeje është subjekt i ratifikimit nga të gjitha vendet anëtare të Bashkimit Evropian. Përkundër faktit që është dhënë përkrahja për fillimin e Studimit të Fizibilitetit, duke pasur parasysh pozicionet e tanishme të Greqisë, Qipros, Rumanisë, Sllovakisë dhe Spanjës ndaj pavarësisë së Kosovës, nuk mund të përjashtohen rreziqet e ngadalësimit të integritetit të saj në Bashkimin Evropian. Për këtë arsye, në vazhdim do të trajtojmë pikat kritike të procesit të integritetit të Kosovës në Bashkimin Evropian, të cilat janë të ndërlidhura me qëndrimin e vendeve të BE-së që nuk e kanë bërë njohjen e saj.

Pas lansimit të Raportit të Fizibilitetit nga Komisioneri për Zgjerim z. Stefan Füle më 27 mars 2012 në Prishtinë, hapi i ardhshëm në këtë proces është përgatitja e Raportit të Fizibilitetit nga Komisioni Evropian, i cili do të vlerësojë kapacitetet e Kosovës për të negociuar Marrëveshjen për Asocim dhe Stabilizim dhe për t'i përmbushur obligimet e saj. Fushat prioritare në të cilat do të bëhet vlerësimi i Kosovës do të jenë tregtia, progresi në reformën e administratës publike, reforma zgjedhore, sundimi i ligjit dhe pakicat, duke përfshirë këtu edhe të drejtat pronësore.



Përgatitja e **Raportit të Fizibilitetit** nga Komisioni Evropian, dhe sidomos rekomandimet e tij, varen nga pozicioni i vendeve anëtare të BE-së. Edhe nëse Kosova dëshmon se ka kapacitete për të negociuar Marrëveshjen për Asocim dhe Stabilizim, nuk garantohet se Këshilli Evropian (për shkak të pesë vendeve që nuk e kanë njohur Kosovën), do të bëjë hapin e ardhshëm, atë të bërjes së ftesës drejtuar Komisionit Evropian që të propozoj draftin e drekcioneve për negociimin e marrëveshjes dhe formimin e Task Forcës Konsultative BE/Kosovë për të përgatitur negociatat. Në rast të vendimit pozitiv, Këshilli Evropian aprovon **direkcionet për negociimin e Marrëveshjes për Asocim dhe Stabilizim**. Kjo pikë (aprovim) në procesin e integritetit të Kosovës në BE është qenësore për të lëvizur drejt **hapjes së negociatave** për Marrëveshjen për Asocim dhe Stabilizim, dhe në kontekstin e tanishëm jodomosdoshmërisht kërkon njohjen e Kosovës nga vendet e BE-së që nuk e kanë bërë deri më tani, por moderimin dhe vullnetin e mirë të tyre. Në aspektin kohor, në rastin më të mirë deri në arritjen e hapjes së negociatave për Marrëveshjen për Asocim dhe Stabilizim do të nevojiten së paku dy vite.

Përvoja e vendeve të Ballkanit Perëndimor tregon se prej fillimit të negociimit

të Marrëveshjes për Asocim dhe Stabilizim deri tek nënshkrimi i saj, mund të nevojiten dy deri në tri vite. **Nënshkrimi i marrëveshjes për Asocim dhe Stabilizim** në mes të BE-së dhe Kosovës, është vështirë të paramendohet pa njohjen nga të gjitha vendet e anëtare të Bashkimit Evropian. Megjithatë, një gjë e tillë nuk mund të përjashtohet me çdo kusht. Kjo, pasi që ndonjë vend i BE-së që eventualisht do të mbetet pa e njohur Kosovën deri atëherë, mund të ndërlidhë njohjen me momentin **ratifikimin e Marrëveshjes për Asocim dhe Stabilizim nga institucionet nacionale**. Me përfundimin e procesit të ratifikimit hynë në fuqi kjo marrëveshje, i cili vendeve të Ballkanit Perëndimor ju ka zgjatur dy deri në tri vite.

Momentum tejet i rëndësishëm për Kosovën është **aplikimi për anëtarësim në Bashkimin Evropian**, gjegjësisht marrja e statusit të kandidatit, i cili jo domosdoshmërisht është i ndërlidhur me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes për Asocim dhe Stabilizim, gjegjësisht ratifikimin e saj nga të gjitha vendet anëtare të BE-së. Formalisht aplikimi për anëtarësim duhet të pranohet nga Këshilli i Unionit Evropian, i cili më pas i përcjellët Komisionit Evropian për të përgatitur **opinionin (Avis) për dhënien e statusit të**

kandidatit vendit aplikant. Komisioni Evropian më pas i dorëzon Pyetësorin vendit aplikant, përmes të cilit merret informacioni për reformat e arritura dhe progresin në harmonizimin e legjislacionit vendas me të gjithë kapitujt e Acquis Communautaire, si dhe vlerësohet kapaciteti për të filluar negociatat për aderim. Bazuar në vlerësimin e vendit aplikant, Komisionit Evropian jep mendimin (Avis) për dhënien e statusit të kandidatit dhe përcaktimin e datës për fillimin e negociatave për aderim, të cilat duhet të aprovohet nga Këshilli Evropian. **Momentum i përshtatshëm për aplikim të Kosovës për anëtarësim në BE, mund të krijohet pas nënshkrimit eventual të Marrëveshjes për Asocim dhe Stabilizim dhe ratifikimit të saj nga shumica e vendeve anëtare të BE-së.**

Kosova mund të përgatitet që tani që krahas negociimit eventual të Marrëveshjes për Asocim dhe Stabilizim të ndërtoj strukturat ndërqeveritare të karakterit administrativ që do të merren me përgatitjen e përgjigjeve në Pyetësorin e Komisionit Evropian. Përgatitjet paraprake të përgjigjeve të azhuruara në Pyetësorin e Komisionit Evropian, si dhe përgatitjet e hershme për **negociatat për akcesion** mund të shkurtojnë ndjeshëm rrugën e Kosovës drejtë anëtarësimit në BE, që përmbyllen me **nënshkrimin e Traktatit të Akcesionit dhe ratifikimit të tij nga vendet anëtare të BE-së**. Padyshim se deri në këtë moment Republika e Kosovës do të njihet nga të gjitha vendet anëtare të BE-së, si dhe nga vet Republika e Serbisë, anëtarësimi i së cilës në BE do të kushtëzohet me njohjen e Kosovës.

Analiza më lartë definon pikat kritike të integritetit të Kosovës në Bashkimin Evropian, që përpos nga performanca dhe progresit të institucioneve vendore, varen drejtpërdrejtë edhe nga qëndrimi i pesë vendeve të BE-s që nuk e kanë njohur Kosovën. Në rastin ideal, pra të mos pengimit të Kosovës në këtë proces, korniza kohore deri në hyrjen në fuqi të Marrëveshjes për Asocim dhe Stabilizim në mes Kosovës dhe Bashkimit Evropian mund të jetë prej 5 deri në 7 vite,



ndërsa ajo anëtarësimi prej 12 deri në 15 vite, nëse në ndërkohë Brukseli nuk e ndërron politikën dhe merr vendim për anëtarësim en-block të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Le ti kthehemi tani pesë vendeve të BE-së që nuk e kanë njohur ende Kosovën. Këto vende nuk kanë qëndrime të njëjta për sa i përket Kosovës në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e Brukselit me Prishtinën. Por, përvoja e deritanishme tregon se vendimet e përbashkëta të arritura në Këshillin Evropian, jodomoshmërisht përkthehen në politika të moderuara të jashtme të natyrës bilaterale të këtyre vendeve ndaj Kosovës, të cilat janë të domosdoshme për të siguruar parashikueshmërinë e integritetit të Kosovës në BE. Me këtë rast do theksuar se asnjë zyrtarë i lartë i Qipros, Rumanisë dhe Spanjës nuk e ka vizituar Kosovën, që nga shpallja e pavarësisë në shkurt të vitit 2008, ndërsa kontaktet me këto vende janë të nivelit joformal dhe ato zakonisht realizohen në forumet multilaterale. Greqia dhe Sllovakia në këtë aspekt janë treguar më të moderuara dhe fleksibile ndaj kontakteve

bilaterale. Në anën tjetër, Qiproja dhe Spanja, për dallim nga Greqia, Rumania dhe Sllovakia nuk kanë zyre në Kosovë, dhe nuk e mbulojnë atë nga asnjë shtet, dhe asnjëra nuk kontribuon në misionin e EULEX-it apo të KFOR-it.

Për të mos ngecur integrimi në Bashkimin Evropian për shkak të faktorëve të jashtëm, është i domosdoshëm një tranzicion i pozicioneve të vendeve të BE-së që nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës nga pozitat e tanishme, në moderim progresiv të marrëdhënieve bilaterale me Prishtinën, që do të duhej të kurorëzoheshin me njohjen e pavarësisë së Republikës së Kosovës dhe vendosjen e marrëdhënieve diplomatike.

Paralel dhe në ndërvëshmëri me procesin e integritetit në Bashkimin Evropian, do të vazhdoj edhe dialogu në mes Kosovës dhe Serbisë, i cili në rast të rrethanave të volitshme mund të shpie deri tek normalizimi i plotë i marrëdhënieve në mes dy vendeve brenda dy deri tri viteve të ardhshme. Kombinimi i këtyre dy faktorëve mund të krijoj edhe momentumin për njohjen e Kosovës nga dy deri katër vendeve të pesës

evropiane, përpos Qipros. Me këtë do të lehtësohej edhe njohja e Kosovës nga Serbia, me të cilën Beogradi do të kushtëzohet herët a vonë gjatë procesit të akcesionit për antarësim në BE.

Për të qenë e sigurt e ardhmja evropiane e Kosovës, dhe për të u shpejtuar përfundimi i stabilizimit të Ballkanit Perëndimor, është e nevojshme që Greqia, Sllovakia, Spanja, Rumania dhe Qiproja, të jenë paraprijëse të ndërtimit të marrëdhënieve me Kosovën në krahasim me Serbinë, e jo përcjellëse reaktive të rezultateve të dialogut të lehtësuar nga BE-ja. Me këtë ndryshim të politikave nacionale në raport me Kosovën do të ndihmohet përshpejtimi i integritetit të Ballkanit Perëndimor në BE, dhe do të arrihet shlyerja përfundimtare e vijave ndarëse në Evropë, që edhe do të shënon suksesin më të madh të Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë të Bashkimit Evropian.

(Lulzim Peci është Ambasador i Republikës së Kosovës në Suedi)

A KA ÇFARË T'I SJELLË KOSOVA BE-SË?

Ilir Dugolli

prill 2012



Duket të jetë mjaft e përhapur bindja që sa më larg aderimit në BE, vendet të cilat ushqejnë aspirata për t'u bërë pjesë e saj, kanë më pak për t'i ofruar unionin më të fuqishëm ekonomik. Prandaj edhe kemi kushtëzimet për ndryshime, përafrim dhe reformim të vendeve kandidate e potencialisht kandidate, në mënyrë që të kenë me çfarë të kontribuojnë në kohën kur kalojnë pragun e vatrës së përbashkët. Përmes procesit të reformave vendet ndryshojnë, jo vetëm për t'i bërë ballë tregut të përbashkët, por edhe për të zgjeruar kufijtë gjeografik të vlerave të BE-së. Motive duket i qartë dhe me interes të ndërsjellë. Me këtë, përshtypja është se vendet sjellin hapësirë të re për treg, fuqi punëtore e përfitime shumëfaqëshe të natyrave nga më të ndryshmet, por se qartazi më e madhe është përshtatja e tyre unionit ekzistues sesa sjellja e rive.

Atëherë, çfarë mund të thuhet për Kosovën, me gjithë pengesat objektive për formalizim të marrëdhënieve me BE-në a me premtimin e vetëm të "perspektivës evropiane"? Për kosovarët janë të qarta përfitimet të cilat u sjell bërja pjesë e BE-së, por a mund të flitet për besim të mirëfilltë brenda BE-së se edhe Kosova ka çfarë t'u sjellë të tjerëve, në këtë rast BE-së? Janë përmendur shpeshherë rinia e përgjithësisht potenciali njerëzor, pozita strategjike në rajon, resurset natyrore dhe aspekte të ngjashme të cilat do të ishin vlerë shtesë për BE-në me Kosovën brenda saj. Janë të shumta përfitimet e tilla të mundshme dhe pesha e tyre s'ka se si

të nënvlerësohet. Por, janë edhe disa përfitime të tjera, tri prej të cilave të përmendura me poshtë, të cilat nuk përmenden zakonisht, të cilat ani se të papërkthyeshme në vlera ekonomike e materiale, megjithatë qojnë peshë të madhe për BE-në.

E para, Kosova mund t'i sjell BE-së mbi të gjitha unitetin. Ndonëse nuk paraqet çështjen e vetme për të cilën vendet anëtare nuk arrijnë të flasin me një zë, skizofrenia në qëndrime ndaj Kosovës ka çmimin e vet edhe për BE-në e jo vetëm për Kosovën. Kjo është anomali e cila përkundër të gjitha eufemizmeve diplomatike, paraqet një handicap serioz për BE-në dhe pretendimet e së njëjtës për faktorizim të mëtejshëm në botë, në përpjekje të adresimit të sfidave politike, të sigurisë a ekonomike.

Në mungesë të një qëndrimi unik në raport me Kosovën, BE shpenzon energji në gjetje të zgjidhjeve *ad hoc* apo alternativave të dorës së dytë. Me vet animin kah këto alternativa, edhe rezultatet në terren s'kanë si të jenë tjera, pos të dorës së dytë. Kështu p.sh. emëruesi i përbashkët në formë "neutralitetit ndaj statusit" nuk mund të jetë mekanizëm i mjaftueshëm për t'i realizuar synimet deklarative të BE-së dhe as ato të Kosovës.

Kosova mund të ketë nxjerr në sipërfaqe dallimet brenda BE-së dhe mungesa e unitetit paraqet defekt serioz. Për pasojë, formësimi i qëndrimit unik brenda BE-së karshi Kosovës, do të jetë lëksion i mirë për çështje shumë më të ndërlikuara

të cilat nuk do të mungojnë e të cilat s'mund të tolerojnë mungesë uniteti. Nëse karshi shpalljes së pavarësisë BE e ka gjetur vetën të ndarë, për shkak të brendshme shumë më tepër se sa për vet Kosovën, procesi i përafrimi i Kosovës drejt BE-së i ofron mundësi të korrigjimit të handikepit aktual dhe arritjes së unitetit aq të nevojshëm. Sa më herët që kjo të ndodhë, aq më mirë.

E dyta, me ndihmën që, përmes vet ekzistencës së vet, do të duhej t'i sillte BE-së për të qenë unike, Kosova do i sillte asaj edhe qartësinë. E lidhur ngushtë me të parën është arritja e aftësisë për të qenë i qartë ndaj Kosovës dhe vendeve të tjera në rajon. Pasojë e mungesës së unitetit është dhënia e mesazheve të dyfishta, ku përshtypja krijohet nga njëherë që nga ana e BE-së një gjë thuhet në Beograd dhe tjetra në Prishtinë.

Për arritje të synimeve, reformim thelbësor të vendeve të rajonit e të marrëdhënieve ndërmjet tyre, kërkohen mesazhe pa ambiguitete, veçanërisht për çështje qenësore, si ato të kufijve, shtetësisë, fqinjësisë së mirë etj. Në mungesë të qartësisë së tillë do të vazhdohet të humbet kohë e vlefshme për arritje të ndryshimeve të thella socio-ekonomike. Rrjedhimisht, përballja e vazhdueshme me ekzistencën e Kosovës, do të duhej ta nxiste BE-në drejt qartësisë të qëndrimeve. Kjo tutje do sillte kristalizim në mesazhe të cilat u drejtohen të gjitha palëve në rajon dhe përfundimisht avancim më të shpejtë e me të qëndrueshëm të të gjithëve drejt BE-së.



E treta që Kosova do t'i sillte BE-së, si rrjedhë e natyrshme e dy aseteve të lartpërmendura, është suksesi. Pothuajse nuk ka zgjidhje institucionale e ligjore të instaluar në Kosovë, që nuk ka për nun ndonjë prej institucioneve të BE-së. Përfshirja e BE-së, si para pavarësisë ashtu edhe pas shpalljes, është e shumanshme në dizajnimin e institucioneve, zgjidhjeve ligjore dhe përgjithësisht vendimeve më të rëndësishme për shoqërinë kosovare. Rrjedhimisht, dështimi i Kosovës do të ishte

edhe i BE-së, ndërkohë që suksesi i Kosovës, vetvetiu do të ndahej me BE-në.

Ndonëse është e padiskutueshme që Kosova ka goxha rrugë për të bërë derisa të shoh veten si anëtare të BE-së, do të duhej të jetë po aq e qartë se ka mjaft për t'i ofruar klubit pjesë e të cilit synon të bëhet. Interesi i anëtarësimit do të duhej të jetë evident dhe të shihet si i ndërsjellë. Në kohën kur kriza financiare dhe preokupimet ekonomike vënë në hije shumë aspekte të tjera të veprimit të BE-

së, ajo do të mund të përqendrohej më shumë, jo vetëm në avancimin e reformimit të Kosovës, por edhe në arritje të unitetit në raport me Kosovën, si e metë aktuale e serioze e cila s'guxon të mbahet nën çilim. Uniteti në fjalë do i mundësonte sjell qartësi veprimi, ndërsa kjo fundit, s'ka se si të mos sjell sukses më të madh.

(Illir Dugolli është Ambasador i Republikës së Kosovës në Belgjikë.)

VEPRIMI I RIMARRJES: SI T'JU NDIHMOHET SERBISË DHE KOSOVËS TË ECIN DREJT BE-SË?

Jordi Vaquer i Fanes
dhe Cristian Ghinea
mars 2012



Shqyrtim strategjik i mosnjohjes së Kosovës

Katër vjet pasi Kosova shpalli pavarësinë e saj, të pesë shtetet anëtare të BE-së të cilat nuk e njohin atë rrezikojnë që të zihen ngushtë në një situatë mbrojtëse në BE, përkundër lëshimeve të tyre të shumta, dhe të mbesin me kërcënimin e vetos si atu i tyre për çështjet lidhur me Kosovën. Duke ju falënderuar marrëveshjes ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës për emërtimin, të pesë vendet tani kanë rast t'i mendojnë sërish objektivat dhe strategjitë e tyre dhe ta shfrytëzojnë mosnjohjen e tyre në një mënyrë të re e cila ua mundëson atyre jo vetëm që të jenë konstruktiv, ashtu siç e kanë dëshmuar në të kaluarën, por po ashtu edhe pro-aktiv dhe strategjik. Për ta shfrytëzuar rastin, ato duhet:

Ta lënë mënjanë frikën e njohjes së fshehtë. Është gabim preokupimi me njohjen 'e pashprehur me fjalë' ose 'të nënkuptuar', i cili ka ndodhur në shumë konflikte dhe bllokada. E tërë poenta lidhur me njohjen është që ajo është publike dhe zyrtare. Vendimi për njohje do të jetë gjithmonë në duar të secilit shtet.

Ta shfrytëzojnë marrëveshjen Beograd-Prishtinë për emërtimin për të ndikuar në të gjitha çështjet. Dialogu i tyre është në pajtim me qëndrimin e të pesë shteteve mos-njohëse të BE-së, të cilat pohojnë që statusi i Kosovës nuk duhet të zgjidhet pa bisedime të drejtpërdrejta ndërmjet dy palëve. Tani që ka pasur si rezultat emërtimin që pranohet nga të dy palët, ai emërtim duhet të shfrytëzohet për ta

lejuar Kosovën të bëhet pjesë e organizatave dhe për përmirësimin e marrëdhënieve me BE-në, përfshirë Marrëveshjen e plotë për Asociim dhe Stabilizim.

Të përqendrohen në integrimin e Serbisë dhe të Kosovës në BE. Të gjitha vendet e BE-së pajtohen që e ardhmja e tyre është në BE, pavarësisht nga statusi i tyre. Prandaj, objektiv nuk duhet të jetë bllokimi i njohjes ose mbështetja e njëres palë dhe jo e tjetrës, por shfrytëzimi i qëndrimit pakicë të vendeve mos-njohëse për ta orientuar Beogradin dhe Prishtinën drejt reformës dhe kompromisit, të cilat janë të domosdoshme për para-anëtarësimin e tyre në BE.

Ta transmetojnë më mirë mosnjohjen dhe motivimet e saj. Përkundër mohimit të vazhdueshëm nga qeveritë e tyre, vëzhguesit dhe partnerët në Ballkan, në Evropë dhe përtej saj dhe audienca e vendit e lidhin mosnjohjen e pesë shteteve anëtare të BE-së me motivimet e tyre të brendshme. Me përjashtim të Greqisë, hapat konstruktivë të shumicës së pesë vendeve mos-njohëse kanë ndodhur prapa dyerve të mbyllura dhe prandaj janë të padukshëm dhe nuk kanë ju kanë sjellë kurrfarë dobie vendeve mos-njohëse.

Hyrje

Një ditë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në shkurt 2008, u shuan të gjitha shpresat që BE-ja do të mbante qëndrim të përbashkët. Ministrat për punë të jashtme të 27 vendeve nuk mundën të pajtohen për një qëndrim të përbashkët dhe në vend të kësaj miratuan një

deklaratë që vërtetonte dështimin e tyre për të reaguar në mënyrë të unifikuar për një ngjarje për të cilën ata kishin pasur njohuri të mjaftueshme paraprake. Rezultati ishte varg i njohjeve të cilat humbën vullin gjithnjë e më shumë deri në njohjen nga Portugalia në tetor 2008. Në atë periudhë, pesë shtetet anëtare nuk e kishin njohur dhe qëndrimi i tyre u ngulit gjatë viteve pasuese. Prej atëherë BE-ja ka qenë e ndarë dhe është përpjekur të gjejë formula për t'u marrë me Serbinë dhe, në veçanti, me shtetin e sapolindur, Kosovën, të cilin nuk mund ta njihte për shkak të mungesës së konsensusit.

Katër vjet prej pavarësisë ka pasur bllokime dhe akuzime të ndërsjella, padi reciproke dhe gjendje pa rrugëdalje, frustrim dhe fyerje ndërmjet njohësve, mos-njohësve dhe institucioneve të BE-së. Muajt e parë pas pavarësisë u karakterizuan me pabesi dhe një lojë të fajësimit të ndërsjellë dhe ende janë larg nga shuarja. Me orë të tëra të gjata janë kaluar duke i diskutuar çështjet e emërtimit dhe të aspektit ligjor, në dëm të ndonjë përparimi substancial. Megjithatë, do të ishte gabim që të përshkruhet një situatë e pasivitetit të plotë: të 27 shtetet anëtare dhe institucionet e BE-së kanë gjetur formula dhe kompromise për të vepruar në një numër çështjesh, nga vendosja e misionit EULEX deri te përfshirja substanciale e BE-së në dialogun ndërmjet autoriteteve të Beogradit dhe të Prishtinës.

Mbas gjase të gjitha palët kanë bërë gabime dhe ka hapësirë për kompromis dhe ndryshim në të gjitha drejtimet.

Megjithatë ky studim adreson në mënyrë specifike qëndrimin e të pesë shteteve anëtare të cilat nuk e kanë njohur Kosovën si shtet të pavarur: Qiproja, Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Spanja. Duke e bërë këtë, studimi hedhë poshtë qëndrimin që mosnjohja është thjeshtë strategji penguese dhe, duke qenë pakicë në BE dhe duke mos e ndryshuar qëndrimin e tyre në pajtim me shumicën, mos-njohësit duhet të fajësohen jo vetëm për ndarjen në BE, por po ashtu edhe për zhgënjimet e veprimet të BE-së me Serbinë dhe me Kosovën.

Objektiv i këtij studimi është të shqyrtohet qëndrimi i mosnjohjes së Kosovës në frymën e sfidave dhe të zhvillimeve aktuale në rajon. Qëllim nuk është përkrahja për ose kundër njohjes. Përqendrimi është në hapat praktikë që të pesë vendet mos-njohëse të BE-së do të mund t'i ndërmerrnin për t'i shërbyer objektivit të përdorur bashkë të lehtësimit të rrugës së Serbisë dhe të Kosovës drejt anëtarësimit në BE. Para se t'iu kthehemi atyre hapave praktikë, megjithatë, ne do t'i përvijojmë dhjetë supozimet dhe do ta shqyrtojmë zhvillimin e mosnjohjes si qëndrim brenda BE-së.

Dhjetë supozimet

1. Vendimi për ta njohur ose mos-njohur është politik, në duart e qendrave më të larta të vendosjes në secilën prej pesë qeverive dhe jo vetëm përshtatje teknike. Megjithatë, në kundërshtim me perceptimet e përgjithshme, mosnjohja nuk është interes jetik për asnjërin prej pesë vendeve mos-njohëse të BE-së. Ka ndikim të kufizuar në arenën e tyre të brendshme (edhe pse duket që të gjitha pesë vendet kanë shumicën shoqërore kundër njohjes) dhe madje as në pozitën e tyre ndërkombëtare. Krahasimet me situatat si ato në shtetin Bask dhe në Kataloni, pakicat hungareze, Transdnistria ose Qiproja Veriore thjeshtë janë të papërshtatshme për t'u mbrojtur.
2. Nuk ekziston rreziku i njohjes rastësisht ose pa e kuptuar. Përkufizimit se cilat akte të sakta përbëjnë njohje të

nënkuptuar ndryshojnë si në praktikë ashtu edhe në doktrinë, por mund të supozohet me siguri që njohja është një akt ndërkombëtar dhe prandaj mund të vendoset me qëllim vetëm nga qeveria e një vendi. Është bërë klishe që njohja të krahasohet me shtatzënsinë (*ose je ose nuk je shtatzënë*) por, siç tha një diplomat që shërben në Prishtinë, krahasimi është çorientues: njohja, për dallim nga shtatzënsia, nuk mund të ndodhë gabimisht.

3. E ardhmja e Serbisë dhe e Kosovës është në Bashkimin Evropian nëse qytetarët e tyre zgjedhin kështu, dhe me kusht që secili vend i bën reformat e duhura për plotësimin e të gjitha kriterëve për anëtarësim. Të dy anëtarësimet janë të ndërlidhura ngushtë, por asnjëri prej vendeve nuk duhet të lejohet ta kushtëzojë ose ta bllokojë rrugën e tjetrit për në BE. Disa shtete anëtare të BE-së (në veçanti Gjermania) tani kanë deklaruar publikisht që Serbia nuk mund të hyjë në BE me pretendime të hapura territoriale ndaj Kosovës – Serbia nuk mund t'i ketë të dyja, edhe Kosovën edhe anëtarësimin në BE. Vendet mos-njohëse që e mbështesin integritimin e Serbisë në BE duhet t'i mendojnë sërish taktikat e tyre në pajtim me situatën e re.
4. BE-ja është dobësuar nga ndarja lidhur me njohjen, jo vetëm se kjo pengon vendosjen e vistrës së instrumenteve që janë dëshmuar të dobishme në shkaktimin e reformës në vendet e tjera në rajon, por po ashtu për arsye se vetë imazhi i BE-së dhe si pasojë edhe ndikimi, tërheqja dhe fuqia e dobët e BE-së vazhdojnë të vuajnë. E çara lidhur me njohjen e megjullon rrugën e Serbisë dhe të Kosovës për anëtarësim në BE.
5. Njohja e plotë e Kosovës nga ana e Serbisë nuk do të ishte vetëm një vendim jashtëzakonisht i vështirë për t'u marrë nga aspekti politik, por do të ishte po ashtu kundër Kushtetutës, e cila mbrohet nga ndryshimi me anë të kërkesave shumë të rrepta. Në të

vërtetë, çdo hap drejt marrëdhënieve më të mira me Kosovën bart një çmim politik. Për këtë arsye, të pesë vendet mos-njohëse nuk duhet ta lënë Serbinë në pozitë në të cilën duhet ta bëjë hapin e parë. Ndikimi të cilin pesë vendet mos-njohëse e kanë mbi Beogradin duhet të shfrytëzohet për inkurajimin e Serbisë që të bëjë hapa pajtues, të cilët në anën tjetër do ta afronin vendin më afër BE-së.

6. Entuziazmi pas pavarësisë në Kosovë po bie shpejt dhe koncesionet nga Prishtina bartin një çmim gjithnjë e më të madh. Vendi vuan nga problemet ekonomike, sundimi i pamjaftueshëm i ligjit dhe zhvillimi i pamjaftueshëm institucional. Izolimi i saj nuk ka kuptim – BE-ja nuk mund ta lejojë një vrimë të zezë në oborrin e vet. Por ka shumë opsione ndërmjet izolimit dhe njohjes. Gjendja në Kosovën Veriore po e shton tendosjen. Në Kosovë, si në Serbi, mbajtja e *status quo-s* i ka kufijtë e vetë dhe mund të ketë për pasojë kundër plasje në procesin e reformës dhe të pajtimit.
7. Si në Serbi ashtu edhe në Kosovë ekzistojnë pjesë të shoqërisë të cilat janë të gatshme të bëjnë kompromis dhe t'i pranojnë zgjidhjet të cilat do të duhet që jo vetëm ta trasojnë rrugën për integritimin e tyre evropian, por po ashtu do të duhej të jenë bërthamë për përmirësimin e fqinjësisë. Mbështetësit e evropianizimit dhe të moderuarit në Serbi dhe në Kosovë duhet të inkurajohen dhe të përkrahen dhe, në të njëjtën mënyrë, radikalët në secilën anë duhet të dekurajohen nga të menduarit që cilido shtet anëtarë, që ka njohur apo nuk ka njohur Kosovën, është në anën e tyre nacionaliste. Në veçanti, pro-evropianët serbë do të forcoheshin në vendin e tyre nëse të pesë vendet mos-njohëse e udhëheqin rrugën në kërkimin e zgjidhjeve të mesme me Kosovën.
8. Realiteti në terren nuk mund të injorohet, por ai nuk është i pandryshueshëm: ka ndryshuar në të kaluarën dhe mund të ndryshojë përsëri

në të ardhmen. Republika e Kosovës nuk është një subjekt që do të zhduket nëse dikush e injoron atë; ajo ushtron një shkallë të konsiderueshme të pushtetit dhe të legjitimitetit në pjesën më të madhe të territorit dhe gëzon mbështetje dhe njohje të gjerë ndërkombëtare. Është e qartë, madje edhe për shumicën e serbëve, që Serbia nuk mund ta ri-inkorporojë Kosovën pa kosto të pambrojtur ekonomike dhe konflikte të rrezikshme. Në Kosovë mbetet tendosja me popullsinë serbe, në veçanti në veri të lumit Ibër dhe nuk do të zhduket pa zgjidhje politike. I gjithë diskutimi lidhur me njohjen nuk mund të kryhet ndaras nga gjendja në terren dhe duke i shpërfillur opsionet të cilat realisht janë të hapura.

9. Kosova është bërë kartë gjeopolitike për shumë vende që tregojnë pak ose aspak interesim për perspektivën në BE të Serbisë dhe të Kosovës, dhe në të vërtetë për disa, si Rusia, që kanë treguar armiqësi për perspektivën e tillë. Mos-njohësit e BE-së nuk duhet të bien në kurthin e atyre që e shohin Kosovën si rast abstrakt, pavarësisht nga mirëqenia dhe perspektiva e ardhme e banorëve të saj dhe duhet të sigurojnë që ta mbajnë qëndrimin e tyre në atë mënyrë që e favorizon integritimin e Serbisë në BE.

10. Nuk u realizua frika nga efekti domino në Ballkan pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Madje nuk shkaktoi as efekte të valëzimit as gjetkë në Evropë ose në kontinentet e tjera, me një përjashtim: Rusia nuk e përmendi precedentin e Kosovës kur e njohu pavarësinë e Osetisë Jugore dhe të Abkazisë (të cilat kishin shpallur pavarësinë vite të tëra para Kosovës). Moska pohon që Kosova krijon precedent të rrezikshëm por ajo ka qenë vendi i vetëm që ka vepruar në atë precedent. Pas katër vjet pavarësi dhe mendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, Kosova ka humbur pjesën më të madhe të spikatjes ndërkombëtare dhe duhet të gjykohet në bazë të meritave të saj në vend të



frikës të efekteve jo-ekzistuese domino deri më tani.

Mosnjohja në kërkim të një strategjie

Për qëllime të kursimit të të shprehurit, në këtë studim flasim për 'pesë mos-njohësit e BE-së'. Kjo shprehje, megjithatë, mund të jetë çorientuese meqë ato pesë shtete anëtare nuk janë një bllok brenda BE-së, madje nuk kanë lidhje me Serbinë dhe Kosovën. Secili vend i ka motivimet dhe politikat e tij ndaj secilit prej dy vendeve. Ekzistojnë qasje të ndryshme për çështjet kryesore, siç është mënyra e mbajtjes së marrëdhënieve të drejtpërdrejta me autoritetet e Republikës së Kosovës ose çka do të nënkuptonte dhe çka nuk do ta nënkuptonte njohjen e fshehtë. Megjithatë mosnjohja është bërë çështje kryesore në BE, në debatet ndërkombëtare dhe rajonale dhe shpesh këto pesë vende janë gjetur së bashku dhe nuk janë pajtuar me pjesën më të madhe të homologëve të tyre të BE-së. Katër vjet pasi që këto vende vendosën të ndahen nga pjesa më e madhe e partnerëve të tyre të BE-së dhe të mos e njohin pavarësinë e Kosovës, mund të jetë e dobishme të vlerësohet çka kanë

fituar ato duke ju falënderuar mosnjohjes, çka nuk arritën, në çka dallojnë qëndrimet e tyre dhe ku qëndron mosnjohja në këtë pikë të debatit.

Atë që nuk ka arritur ta bëjë mosnjohja është ndalja e procesit të njohjes nga shtetet e tjera anëtare të BE-së, ose madje nga shtetet që nuk janë anëtare të BE-së (edhe pse mund të kenë ndikuar në ngadalësimin e njohjeve). Mos-njohësit po ashtu nuk ia kanë dalë të shkëputen nga imazhi se mosnjohja kishte të bënte me problemet e tyre dhe jo me qëndrimin e tyre në rajon. Duke u frikësuar që do të shihen si jo-koherent me qëndrimin e tyre, ata bllokuan nismat dhe, kurdo që tregonin fleksibilitet dhe gjenin mënyra për të vazhduar, në veçanti në marrëdhëniet me Kosovën, ata vendosën që ta bëjnë këtë në mënyrë diskrete dhe pa dijeninë e opinionëve të tyre publike ose të atyre të rajonit. Si rezultat, kosovarët ndjehen të armiqësuar, sikur vendet mos-njohëse (me përjashtim të Greqisë) të jenë kundërshtarë të tyre, ndërsa disa serbë ndihen të shfrytëzuar për interesat e brendshme të vendeve mos-njohëse. Miqësia me Serbinë nuk ka rezultuar me avantazhe të mëdha afariste për vendet mos-njohëse (për

shembull, kompanitë spanjolle duket që nuk kanë fituar në mënyrë të pabarabartë nga kontratat shtetërore në Serbi krahasuar me ato të homologëve francezë apo italianë), dhe këto të pestat nuk ju kanë shmangur mosmarrëveshjeve bilaterale (siç është ajo me qeverinë rumune lidhur me pakicën vllahe).

Dallimet ndërmjet mënyrave sipas të cilave vendet mos-njohëse i interpretojnë dhe i miratojnë mosnjohjet e tyre mund të përmblidhen në gjashtë fusha kryesore:

- **Interpretimi i tyre çka është njohja e nënkuptuar** dhe mbështetja ndaj pavarësisë së Kosovës, përmes së cilës Spanja vendosi që duhej t'i tërhiqte trupat e saj nga KFOR-i, por jo Greqia ose Rumania.
- **Gatishmëria e tyre për ta bllokuar BE-në dhe nismat e tjera ndërkombëtare** për shkak të frikës së njohjes së nënkuptuar, duke e zgjedhur Qipron si vendi që kishte më së shumti mundësi të bllokonte dhe Greqinë si vendi që kishte më së paku mundësi të bllokonte.
- **Gatishmëria e tyre për t'iu kundërvënë pjesës më të madhe të shteteve anëtare të BE-së** dhe madje për ta prishur rreshtin në votimet ndërkombëtare si në KB ose në FMN, Greqia duke qenë më së paku e gatshme të ndahej nga shumica.
- **Marrëdhëniet e tyre të drejtpërdrejta me autoritetet në Prishtinë**, në të cilat Qiproja dhe Spanja kanë qenë më kufizueset (ato nuk kanë prani të përhershme zyrtare në Prishtinë, as nuk zhvillojnë vizita zyrtare).
- **Qasja e tyre tek popullsia kosovare**, ku Greqia ka bërë përpjekje të tregojë mbështetje përkundër mosnjohjes, Sllovakia është përqendruar në pakicat (në veçanti në pakicën serbe), ndërsa tri të tjerat kanë lejuar që perceptimi negativ të ngurtësohet në shoqërinë kosovare. Qëndrimi i Rumanisë në opinionin publik të Kosovës është në veçanti i ndjeshëm, për shkak të vrasjes fatkeqe të dy protestuesve më 2007 nga ana e policëve rumunë të KB-së.
- **Shkalla e përfshirjes emocionale,**

politike dhe personale. Ndërsa në Qipro qëndrimi i vendosur është mbështetur nga i gjithë spektri politik, personaliteti i Presidentit Basesku në Rumani dhe ai i ministrit të jashtëm Moratinos në Spanjë kanë qenë faktorë të rëndësishëm në ashpërsimin e qëndrimit të tyre ndaj Kosovës.

Pesë vendet mos-njohëse janë partnerë të privilegjuar të Serbisë, por në asnjë mënyrë nuk janë të veçantë. Pas reagimeve të para fillestare dhe ndërprerjes së përkohshme kur e njohën Kosovën, praktikisht të gjitha vendet njohëse i kanë normalizuar marrëdhëniet e tyre bilaterale me Beogradin. Me Serbinë që po e vazhdon rrugën e saj drejt BE-së, çështje të reja dhe më komplekse po shfaqen në horizont. Në listën e mbështetësve kryesorë të rrugës së Serbisë për në BE bëjnë pjesë shtetet që e njohin Republikën e Kosovës, përfshirë disa prej përkrahësve më të zëshëm të kërkesës së Serbisë për BE-në, siç janë Italia dhe Sllovenia. Kështu, avantazhet e mosnjohjes në marrëdhënien me Serbinë po shkatërrohen shumë shpejt. Prandaj vendet mos-njohëse kanë më pak ndikim në Beograd se sa që kishin menjëherë pas shpalljes së pavarësisë dhe raporti i tyre po bazohet më pak në lidhjen emocionale. Në anën tjetër, pozita e tyre në Kosovë është e dobët dhe po përkeqësohet edhe më, duke e pasur parasysh rëndësinë e mosnjohjes për autoritetet kosovare. Vetëm Greqia mund të pohojë se ka ndikim në autoritetet e Prishtinës-Greqia ka pasur politikë të hapur që të komunikojë me shoqërinë kosovare dhe të punojë atje, lidhjet ekonomike ndërmjet Greqisë dhe Kosovës janë solide dhe kontaktet e popujve ndërmjet veti janë të shumta. Meqë katër të tjerat kanë qenë të ngadalshme në krijimin e marrëdhënieve dhe, duke refuzuar që të angazhohen me qeverinë atje, në masë të madhe kanë hequr dorë nga aftësia e tyre për të luajtur një rol në anën e Kosovës.

Brenda BE-së, disa prej vendeve mos-njohëse mund të jenë befasuar që janë gjendur në një grup më të vogël se që kanë pritur. Deri sa jo vetëm pjesa më e madhe e shteteve anëtare por, gjithnjë

e më shumë, institucionet e BE-së përpiqen të arrijnë përparim me Kosovë, vendet mos-njohëse janë gjetur në pozitë reaguese. Ato nuk e durojnë presionin nga vendet njohëse dhe në veçanti reagojnë nga ndonjë mungesë e perceptuar e neutralitetit të institucionet siç është Komisioni Evropian. Duke e pasur për objektiv shmangien e njohjes së nënkuptuar si preokupim kryesor, kohën dhe energjinë e tyre e shpenzojnë në krijimin e marrëveshjeve komplekse (në formë të yllit, anekseve, fusnotave, ri-emërimeve dhe bashkëngjijtes së shënimeve sqaruese) me kërcënimin e fundit të bllokimit të përparimit. Kur arrihet një marrëveshje dhe marrëdhëniet me Kosovën ecin përpara, disa prej vendeve mos-njohëse fitojnë përshtypjen (dhe e transmetojnë atë) që kanë bërë lëshim dhe jo që kanë arritur diçka. Pa një vizion strategjik për rajonin që e rishtrukturon mosnjohjen e tyre në avantazh të tyre, mosnjohja bëhet thjeshtë strategji mbrojtëse, me veton si mjetin kryesor të saj.

Koha për shqyrtim strategjik: pranova 2012, një çast i mundësisë

Të qenit në pozitë mbrojtëse kundër përparimit të Kosovës në rrugën drejt BE-së nuk është pozitë e lakmueshme për pesë shtetet anëtare, të cilat nuk janë më të mëdhatë dhe duhet të merren me një agjendë mjaft komplekse të BE-së aktualisht. *Në vend se të mbërthehen në situatë mbrojtëse, vendet mos-njohëse kanë rast të mendojnë sërish për objektivat dhe strategjitë e tyre, dhe ta luajnë mosnjohjen e tyre në një mënyrë të re që ua mundëson që jo vetëm të jenë konstruktive, ashtu si kanë dëshmuar që janë në të kaluarën, por edhe pro-aktive dhe strategjike.* Ky ndryshim do të ishte në veçanti me kohë, meqë momenti aktual është i arrirë me mundësi por po ashtu edhe me rreziqe.

Qe një kohë të gjatë qeveria e Serbisë i ka thënë popullit të saj që Serbia mund ta ketë edhe sovranitetin në Kosovë edhe anëtarësimin në BE. Kryeministri i Serbisë Cvetkoviç ka pohuar që 'përderisa ekziston së paku një vend

¹ http://www.b92.net/eng/news/politics-article.php?yyyy=2011&mm=06&dd=24&nav_id=75084



anëtar (i BE-së) që nuk e njeh pavarësinë e Kosovës, dhe aktualisht janë pesë syresh, njohja nuk mund të jetë kusht për integrim në BE¹. Ky këndvështrim tani është kundërshtuar publikisht nga Kancelarja Merkel e Gjermanisë e cila e ka bërë të qartë që zgjidhja e përhershme e çështjes së Kosovës është kusht i detyrueshëm që Serbia t'i bashkohet BE-së. Kjo ka pasur një ndikim të drejtpërdrejtë në opinionin publik në Serbi dhe në mbështetjen e tij për integrimin në BE, dhe ndikimi i kësaj në popullaritetin e qeverisë do të testohet në zgjedhjet legislative serbe në fund të prillit 2012.

Si kusht për ta fituar statusin e vendit kandidat, nga Serbia është kërkuar t'i arrijë disa rezultate në dialogun e saj me autoritetet në Kosovë. Raundi i bisedimeve që ka përfunduar të premten, më 24 shkurt 2012, në Bruksel ka sjellë përparime në çështje të rëndësishme të vendkalimeve kufitare. Çka është më e rëndësishme, ai ka shërbyer të gjendet një fusnotë për të cilën janë pajtuar dhe është pranuar nga të dy palët e cila kur t'i shtohet emrit të Kosovës dhe të shoqërohet nga një yll duhet t'ia mundësojë Kosovës t'iu bashkohet 36 organizatave rajonale pa u kundërshtuar nga Serbia. Fusnota është kompromis ndërmjet insistimit të Serbisë që të përfshihet përmendja e Rezolutës 1244 të KS të KB dhe synimit të Kosovës që të përmendet Shpallja e Pavarësisë, dhe ajo ka përmbajtjen në vijim:

"Ky emërtim nuk i paragjykon qëndrimet për statusin dhe është në pajtim me Rezolutën 1244 të KSKB dhe të Mendimit të GJND-së për Shpalljen e Pavarësisë së Kosovës".

Marrëveshja hapë mundësinë për të ecur përtej frikës së njohjes së nënkuptuar me një formulë që është e pranueshme nga të dy palët, Beogradi dhe Prishtina. Ajo ka krijuar një atmosferë ku të dy kryeqytetet e ndjejnë presionin nga populli i tyre për të arritur disa rezultate konkrete për lëshimet e tyre. Deri sa zgjedhjet serbe dhe formimi i qeverisë së re në Beograd përvijohen në horizont, mund të jetë koha e fundit që vendet mos-njohëse ta qetësojnë frikën e tyre të njohjes së fshehtë dhe të kërkojnë strategji të reja (secila prej pesë vendeve do ta ketë të veten) për ta shfrytëzuar pozitën e tyre të posaçme për çuarjen përpara të agjendës për integrimin rajonal. Ajo strategji duhet t'i ketë së paku dy faqe, një lidhur me Serbinë dhe një tjetër me Kosovën.

Përtëritja e miqësisë me Serbinë

Deri sa avantazhet e të qenit vend mos-njohës bëhen gjithmonë e më pak të qarta me Serbinë, disa prej të pesë vendeve mund ta ndiejnë nevojën të kërkojnë mënyra për ta ri-balancuar raportin e tyre me Beogradin nga një vizion i ngarkuar emocionalisht (dhe në disa raste personalisht) me një vizion më pragmatik dhe afatgjatë. Vullneti për ta sjellë Serbinë, aktorin kryesor në Ballkanin

Perëndimor, më afër BE-së është objektiv që varet nga aftësia e BE-së që ta shfrytëzojë politikën e saj të karotës dhe shkopit në mënyrë të balancuar dhe t'i realizojë premtimet e dhëna.

Brenda vendit, balanca ndërmjet reformuesve dhe konservatorëve, ndërmjet evropianëve dhe nacionalistëve, është në tranzicion. Përparimi dhe marrja e hapave të rinj në raportin me Kosovën nuk do të jetë i lehtë deri sa rritet presioni mbi qeverinë në Beograd. Kështu, mund të jetë e dobishme nëse vendet mos-njohëse të BE-së do të mund të ishin pro-aktive në ndërmarrjen e disa hapave para se Beogradi t'i ndërmarrë ata, e jo pasi që ai ta bëjë këtë, si mënyrë për inkurajimin dhe ofrimin e një alibie për qeverinë serbe. Mosnjohja nuk do të thotë që të nguliten pas qëndrimit serb, por që të udhëhiqet fronti me shembuj të hapave konstruktivë. Po ashtu, lidhjet me Beogradin do të mund të shfrytëzoheshin për të garantuar që marrëveshjet në dialogun me Prishtinën nuk minohen nga masa shtesë (për shembull lëvizja e mallrave, kur të arrihet marrëveshja nuk pengohet nga kërkesat e mëtejshme për sigurim të automjeteve, ashtu si ka ndodhur), dhe e njëjta gjë do të mund të bëhej me Prishtinën.

Po ashtu do të ishte e dobishme të fitohet sërish uniteti i veprimit brenda BE-së në një shkallë më të gjerë se që ekziston tani. Çështja e njohjes do të mund të përmbledhej relativisht tani që ekziston emërtimi për të cilin ekziston marrëveshje reciproke. Por ekzistojnë çështje të tjera vendimtare ku mungesa e qëndrimit të unifikuar të BE-së është e dëmshme, siç është nevoja për shpërbërjen e strukturave paralele në Kosovë të cilat paguhën nga Beogradi (që është në kundërshtim me Rezolutën 1244 për përfshirjen e së cilës në fusnotë ka insistuar Serbia) ose kundërshtimi ndaj përfshirjes së Kosovës Veriore në Serbi si këmbim ose për tokat të tjera (korridori i Preshevës i populluar nga shqiptarët) ose për njohje. Në të kaluarën, aftësia e vendeve mos-njohëse që të arrijnë tek një spektër më i gjerë i strukturës politike serbe se pjesa më e

madhe e shteteve anëtare të BE-së është dëshmuar e dobishme. Nëse ka ndonjë porosi koherente që duhet t'i dërgohet tërë BE-së, ato lidhje mund të jenë të dobishme në qasjen tek të gjitha pjesët e shoqërisë serbe.

Hapat konkretë për ta sjellë Kosovën më afër BE-së

Ana tjetër e ekuacionit është raporti ndërmjet vendeve mos-njohëse dhe shoqërisë kosovare, autoritetet në Prishtinë, roli i tyre brenda BE-së dhe ndaj integritetit të Kosovës në forumet ndërkombëtare. Nëse emërtimi për të cilin është arritur marrëveshje rishitazi përdoret gjerësisht, ekziston një fushë e madhe e mundësive për të përparuar pa e vënë në pikëpyetje qëndrimin e mosnjohjes. Po ashtu ekziston shumë hapësirë për ndryshimin e natyrës së marrëdhënieve bilaterale me autoritetet në Kosovë: ndërsa Greqia është e gatshme që të takohet dhe të bisedojë me autoritetet kosovare haptazi, katër vendet e tjera mos-njohëse krijojnë situata komplekse dhe nganjëherë madje edhe kundërthënëse duke mos pranuar të takohen me përfaqësues kosovarë, madje edhe në pozita jozyrtare. Më poshtë është dhënë një listë e masave që mund të ndërmerren, disa prej të cilave janë realitet tashmë për disa prej vendeve mos-njohëse, por jo për të gjithat.

- Zhbllokimi i studimit të fizibilitetit për Marrëveshjen për Stabilizim dhe Asociim ndërmjet Kosovës dhe BE-së, për të cilin Përfaqësuesja e Lartë Ashton tashmë ka njoftuar që do ta propozojë Komisioni.
- Pajtimi për Marrëveshjen Kornizë që mund ta lejojë pjesëmarrjen në një spektër të gjerë të programeve të BE-së, në vend se të angazhohen në bisedime rast për rast.
- Gjetja e një formule për Marrëveshje të Tregtisë së Lirë me garanci të plota, në vend të votimit kundër ose abstenimit, në të gjitha organizatat rajonale ndërkombëtare, me kusht që të përdoret emërtimi për të cilin është arritur marrëveshja reciproke.
- Votimi për integrimin e Kosovës, me kusht, në federatat ndërkombëtare të natyrës pjesërisht qeveritare, siç janë federatat e sportit, Komiteti Ndërkombëtar Olimpik, Kryqi i Kuq

ose Evrovizioni. Shumë prej tyre kanë precedent të pjesëmarrjes së jo-shteteve (Skocia, Uells, Ishujt Faro dhe qindra të tjera) dhe anëtarësimi do të kishte dukshmëri të lartë për popullsinë kosovare.

- Lejimi i dokumenteve administrative dhe zyrtare, me masat e nevojshme paraprake, nga Republika e Kosovës, me qëllim të lehtësimit sa më të madh që është e mundur të shkëmbimeve popull-popull dhe të atyre afariste.
- Krijimi i kontakteve të drejtpërdrejta, aty ku nuk ekzistojnë ende, me autoritetet e Republikës së Kosovës, përfshirë vizitat zyrtare, me masat paraprake për simbolet e njohjes.
- Inkurajimi i dialogut politik dhe shoqëror, duke krijuar formula të thjeshta për aktivitetet e departamenteve dhe të punonjësve qeveritarë, parlamentarë dhe autoriteteve lokale dhe rajonale për të bashkëpunuar pa paragjykim me qëndrimin e vendit lidhur me statusin e Kosovës.
- Për ato vende që nuk kanë prani të përhershme në Prishtinë (Spanja dhe Qiproja), ose të hapin prani të përhershme me funksione konsullore, ose t'ia delegojnë ato funksione ndonjë pranie tjetër shtetërore në Prishtinë (mundësisht ndonjë vendi mos-njohës, për shembull Greqisë për Qipron).
- Bëjeni publik qëndrimin konstruktiv për Kosovën dhe për tërë përparimin e arritur në mediat e Kosovës dhe në shoqërinë civile, duke ju treguar atyre që mosnjohja nuk ka për qëllim që të jetë kundër perspektivës së tyre evropiane.
- Përdoreni mosnjohjen për të ndikuar në autoritetet e Prishtinës, për t'i inkurajuar ata që ta zbatojnë reformën kuptimplotë.
- Keni kujdes që ta ndani interesimin e arsyeshëm për të drejtat e pakicave nga qëndrimi i përgjithshëm për njohjen (negativ) dhe për perspektivën në BE të Kosovës (pozitiv).

Përfundim: Lëvizja përtej lojës së (mos) njohjes

Të pesë shtetet që nuk e kanë njohur Kosovën insistojnë, me të drejtë, që qëndrimi i tyre duhet të respektohet brenda BE-së, madje edhe nëse nuk e përbejnë shumicën. Katër vjet pas shpalljes

së pavarësisë dhe në mes të një periudhe të rëndësishme të ndryshimit në Serbi dhe në Kosovë dhe në marrëdhëniet në mes të dyjave, këto vende kanë mbetur pakicë dhe pa ide të qartë lidhur me mënyrën e lëvizjes nga mosnjohja mbrojtëse në strategji pro-aktive që mund të krijohet në bazë të saj me qëllim që t'i kontribuojë integritetit të të dyjave, Serbisë dhe Kosovës, në BE në të ardhmen.

Një dritare e mundësisë është hapur me marrëveshjen për emërtimin e Kosovës që është i pranueshëm nga të dy palët. Kjo tregon vullnetin e qartë si të Serbisë ashtu edhe të Kosovës për të ecur përpara në rrugën e tyre drejt BE-së. Por ekziston po ashtu edhe rreziku që lëshimet nga të dy palët mund të shihen si të tepërta nga popullit, dhe që pro-evropianët në të dy vendet mund ta humbin mbështetjen e popullit nëse ata e perceptojnë që nuk ka përparim. Kompromiset në dialog janë arritur në bazë të premtimeve të rezultateve konkrete nga ana e BE-së dhe mosveprimi në pajtim me këtë do ta shkatërronte më tej qëndrimin e BE-së dhe do t'i forconte aktorët alternativë siç janë SHBA (në Kosovë) dhe Rusia (në Serbi) në perceptimin e shumë qytetarëve.

Vendet mos-njohëse kanë pozicion të mirë që të kontribuojnë në përparimin e vërtetë. Duke e lënë mënjanë frikën nga njohja e fshehtë; duke e shfrytëzuar marrëveshjen Beograd-Prishtinë për emërtimin për përmirësimin e marrëdhënieve BE-Kosovë dhe për ta nxitur integrimin e mëtejshëm rajonal të Kosovës; duke e mbështetur integrimin e Serbisë dhe ithtarët e evropianizimit brenda atij vendi; dhe duke e komunikuar më mirë qëndrimin kundër njohjes brenda BE-së dhe në Kosovë, vendet mos-njohëse kanë mundësi të përfitojnë nga përpjekjet e tyre intensive të katër vjetëve të fundit dhe ta investojnë atë kapital në të ardhmen evropiane të Ballkanit Perëndimor.

(Jordi Vaquer i Fanes është drejtor i CIDOB, Qendra e Barcelonës për Çështje Ndërkombëtare (Barcelonë, Spanjë), ndërsa Cristian Ghinea është drejtor në CRPE, Qendra Rumune për Politika Evropiane (Bukuresht, Rumania))

KOSOVA DHE BE-JA, TË LUFTUARIT PËR NJË MARRËDHËNIE NË KRIZË

Oana Popescu
qershor 2012



“Nëse dashuri te dyanshme nuk mund të ketë, më lejo që më i dashuruari une te jem”²

Ballkani kanë qenë gjithmonë një dhimbje koke. Për të gjithë ata Evropian që duan stabilitetin, urrejnë korrupsionin, dhe mbështesin rregullat dhe rregulloret, Ballkani është një dhimbje koke e tmerrshme. Pse, atëherë, BE do t'i shtonte listës së vet ekzistuese të kokëdhimbjeve financiare, edhe një tjetër – ndoshta atë më nevríkuesin në gjithë Ballkanin? Pse ndjekja Kosovare e anëtarësisë evropiane përmban edhe pak gjasa suksesi? Dhe duke marrë parasysh rebuset e brendshme të Kosovës, pse duhet të supozojmë se diplomacia e saj do të ndjekë këtë kurs pa kurrfarë hezitimi?

Ndoshta për një arsye, por asnjëri nuk kanë zgjedhje strategjike.

Në rastin e Kosovës, kjo ka qenë gjithmonë e qartë. Por më pak në rastin e BE-së —dhe shkurt-pamësia evropiane në këtë drejtim tashmë ka shënuar golat e vet. E absorbuar me problemet vetanake ekonomike dhe të identitetit, me kapacitetin e reduktuar për të menaxhuar diversitetin vetanak, dhe e ballafaquar me krizë serioze udhëheqjeje, **BE-ja është duke humbur besueshmërinë në mbarë botën, e po ashtu edhe forcën tërheqëse dhe ndikimin në rajon.**

Nën rrethana të tilla, BE-ja duhet të kuptojë si kurrë më parë se ajo nuk mund

të bëjë pa Ballkanin — **të tërë** Ballkanin, përfshirë dhe Kosovën. Një përmbledhje e shkurtër tregon pse:

Stabiliteti — BE-ja nuk guxon të i lejojë vetes jo-stabilitet në kufijtë e saj. Gjasat janë se nuk do të kemi luftë tjetër në Ballkan — asnjëra palë nuk do të përfitonte nga kjo. Por një fqinjësi jostabile, me trazira ndëretnike, e në të cilën lëvizin trafikuesit e drogës, rrjetet e prostitucionit, migrimi ilegal, evazoni fiskal, etj., në vend të tregtisë dhe turizmit, është diçka që shkon në kundërshtim me zhvillimin ekonomik, progresin social e politik, dhe ndryshon drejtimin energjisë dhe burimeve të rëndësishme nga fushat tjera.

Serbia vetë, si një shtet kyç në rajon, nuk mundet dhe nuk duhet të luajë rolin e garantuesit të vetëm të sigurisë, në një 'sferë influence' me logjike të kohës se Luftës së Ftohtë. Megjithatë, ky do të jetë realiteti nëse partnerët evropian zgjedhin të shmangen seriozisht nga përgjegjësitë e tyre. Kjo do të ishte e rrezikshme për rajonin dhe për Serbinë — e lënë në duart e Rusisë dhe me inventivë të vazhdueshëm që t'i përdorë pakicat e veta në shtetet fqinje për të 'përçarë dhe sunduar' në vend se të përqendrohet në zhvillimin vendor. Prandaj, kurrfarë stabiliteti nuk do të arrihet përderisa Kosova të mbetet plagë e pashëruar, me status të paqartë politik, me kufij të kontestuar, dhe veri pa ligj. Procesi i integritimit ofron të vetëm rrugë të demonstruar për ndryshim total të paradigmes: të kthimit të mendjes se njerëzve drejt bashkëpunimit, pajtimit, progresit ekonomik — duke shikuar para,

në vend të dallimeve të së kaluarës. Prandaj, ta lësh Kosovën jashtë, është pothuajse gati një provokim i hapur.

Ekonomia. Siç Gjermania ka kuptuar rishtazi, gjatë krizës ekonomike dhe financiare, shtetet e Evropës Qendrore dhe Lindore mund të jenë më të favorshme me kujdesin e tyre fiskal, potencialin për rritje, dhe popullatën tashmë të mësuar t'i përballojë vështirësitë. Përveç kësaj, kur të fillojë procesi i para-anëtarësimit, Brukseli ka mjete dhe nxitës të fuqishëm t'i stimulojë reformat dhe financat e shëndosha të këtyre shteteve më tutje. Por keni kujdes: Brukseli mund ta bëjë këtë **vetëm** kur të ketë filluar procesi. Në këtë drejtim, Kosova mund të jetë treg i vogël me ekonomi të re. Por mbi të gjitha, në rajon dominon ndërvarësia, dhe as një shtet, me përjashtim (të padëshirueshëm) të Serbisë, do të jetë në gjendje të qëndrojë vetë në këmbët e veta.

Gjeostrategjia. Energjia dhe rrugët e tregtisë. Ndikimi rus. Territori. Dalja në det. Demografia. E gjithë "pjesa tipike mekanike" e sigurisë është aty kur vije radha të Ballkani, gjë e rëndësishme kyçe për Evropën. Është e rëndësishme të ceket se Kosova ka popullatë të re në moshe, laike, pro-evropiane, që flet gjuhën angleze dhe gjermane, përderisa Evropa është duke u mplakur dhe duke vuajtur nga deficit i fuqisë punëtore në shumë sektorë. Kjo popullatë është po ashtu e varfëruar e cila, po që se mbahet në varfëri, do të gjejë rrugët për t'iu bashkuar diasporës

² W.H. Auden, The More Loving One



ekzistuese Kosovare në Zvicër, Gjermani, dhe Skandnavi. Të gjitha këto shtete tashmë janë duke u ballafaquar me probleme madhore të migrimit. Megjithatë, në kohën e internetit, kanaleve televizive me lajme 24 orë, dhe me ekspozimin që Kosovarët kanë në perëndim, njerëzit nuk mund të mbahen mbyllur më. Pyetja në të vërtetë është nëse duam të kemi migrim legal apo ilegal, sepse prapëseprapë ne **do ta kemi**. Por megjithatë shumë më pak nëse Kosovarët do të kenë mundësi të ndërtojnë të ardhmen në shtëpi. Përveç kësaj, ekziston një popullaritet i dukshëm i idesë euro-atlantike e cila dominon në (shumicën) e këtyre vendeve (Kosova është **kampioni** i kësaj), për dallim nga eurofilia gjithnjë në rënie brenda dhe jashtë Evropës – elementi i fuqisë së butë për të cilin Brukseli ka tepër shumë nevojë në kohën e diskutimeve globale mbi rënien e Perëndimit.

* * *

Me siguri që kriza aktuale e Eurozonës vetëm dëshmon dhe një herë **se zgjerimi nuk duhet të bëhet më shpejtë se sa mund të menaxhohet**. Por derisa Evropa është në proces të të kuptuarit të biznesit të saj vetanak, ajo duhet ta zhvillojë së shpejti një vizion të qartë që së paku ta mbajë Ballkanin perëndimor në raport të afërt me vetveten. E mira e gjithë fazës së para-anëtarësimit është se ajo ofron **të vetmet** mekanizma solid për t'iu afruar Evropës dhe për të vazhduar zhvillimin e vet, përderisa Brukseli mund të vonojë aderimin për aq gjatë sa është e nevojshme që të dy palët të jenë të gatshme. Një lloj i një raporti të hapur, i cili mund të përfundojë me martesë, apo vetëm në bashkëjetesë të lumtur pa obligime.

Është e vërtetë se BE-ja nuk preferon të futet në marrëdhënie pa parakushte të forta – por tani për tani ajo është duke u sjellë si një partnere e pamatur, i pasigurte

nëse do të i përkushtohet lidhjes apo jo. Përderisa ajo të zgjedh të zhagit këtë marrëdhënie të paqartë për aq gjatë sa është e mundur, ajo duhet të jetë e vetëdijshme se “i dashuri i saj” mund të joshet nga një aferë tjetër më premtuese.

Zbrazëtitat që BE i krijon me mosveprim mbushen nga të tjerët. Asnjë territor nuk mbetet i papushtuar për një kohë të gjatë. Në Afrikë, kinezët kanë hyre aty ku Evropa ka dështuar të realizojë. In Lindjen e Mesme, Islamistët po arrijnë në demokracitë e reja. Në zemër të Evropës janë popullistët ata të cilët po i mbushin zbrazëtitat. Por shembulli më i mirë nga rajoni është ndoshta ai i Turqisë. BE-ja i ka kërkuar vazhdimisht që kjo të i përmbush kërkesat e matricës së paracaktuar të identitetit evropian – përderisa dinamikat e brendshme turke dhe konteksti i jashtëm global të kenë shtyrë këtë vend euroaziatik drejt qëndrimit më të pavarur, multilateral, e ndonjëherë gjithnjë e më tepër jo-Evropian.

Kosova nuk është në pozitë të luajë lojëra aq komplekse. Por të tjerët janë, dhe ata luajnë lojëra të rrezikshme në Kosovë dhe Ballkan. Rusët, Turqit, dhe islamistët janë duke ushtruar ndikim të fuqizuar nga paratë e gatshme. Katari dhe Arabia Saudite janë duke zënë pikëmbështetje në stil të Hezbollahut, duke shpenzuar bollshëm në shkolla dhe rrugë –por vetëm pasi vendorët të pranojnë së pari xhaminë ose shkollën fetare. Baronët e kimit të organizuar dhe nacionalistë të radikal të të gjitha formave tani po formojnë një klasë të re sunduese. Grupet e tilla jo gjithmonë kanë fuqinë të ndërtojnë forma të caktuara të shoqërisë (e sigurisht jo-evropiane), por ata kanë pa dyshim fuqinë që të trazojnë një shoqëri të ndërtuar në parime evropiane. Tani për tani, në vend se Kosova shumë laike të shërbejë si shembull i integritimit në një kontinent të turbulluar me përplasjet mes kulturave vendore dhe imigrante dhe fesë, ne ballafaqohemi me kërcënimin e humbjes së mu kësaj harmonie.

* * *

Për t'i bërë gjërat dhe më sfiduese në kohën kur BE-ja është kthyer nga brenda, përveç lodhjes ekzistuese nga zgjerimi, qasja e saj ndaj Ballkanit Perëndimor po del të jetë kontradiktore dhe ngurruese –mu ashtu siç BE-ja edhe shfaqet përgjithësisht në gjithë skenën botërore. Pasi që kosovarët qenë inkurajuar që të ndërtojnë shpresa të mëdha dhe jorealiste para dhe pas pavarësisë, humbjen e reputacionit të cilën po e përfetojnë tani i shkon për favor të kundërtës të reformave entuziaste pro-evropiane. Dhe duket që në kemi harruar se rrugëtimi është po aq i rëndësishëm sa edhe vetë destinacioni. Tani, BE-ja është duke kaluar një krizë të brendshme pikërisht se ajo ka dështuar të mbajë premtimet e veta kryesore të kohezionit social dhe prosperitetit ekonomik dhe sepse ajo ka humbur kontaktin me qytetarët e saj. Prandaj, t'ia mbash Ballkanit Perëndimor derën të mbyllur, por t'i lësh ta zënë derën me këmbë nuk do të ketë efekt me këto shtete. Brukseli,

Berlini, apo Parisi nuk mund të pretendojnë t'ua mësojnë Prishtinës, Shkupit, apo Beogradit parimet evropiane përderisa ato vetë nuk ushtrojnë atë që e predikojnë.

Rasti i liberalizimit të vizave e pasqyron këtë shumë qartë: thënia se "Prishtina nuk i ka përbushur detyrat e saj të shtëpisë dhe për këtë shkak nuk mund të i jepet liberalizimi i vizave" nuk do të ketë efekt përderisa i) Brukseli nuk i ka artikuluar as vetë qartë këto detyra shtëpie dhe ii) shumë vende në fakt nuk duan të shohin se Kosovarët udhëtojnë lirshëm nëpër Evropë, nga frika e imigrimit – dhe kjo është mjaft e qartë, siç është vërtetuar në shumë raste, nga debatet televizive deri të rezultatet e zgjedhjeve franceze. Nëse këto vende ishin me të vërtetë të përkushtuara që Kosovës të i jepet udhëtimi pa viza bazuar në performancën qeveritare, ato do të kishin mënyra shumë të fuqishme që t'i bëjnë presion vendim-marrësve në Prishtinë, duke ia ekspozuar qytetarëve të saj se si mungesa e performancës së qeverisë po u del para përbushjes së të drejtave të tyre natyrore. Por kur deklaratat e tilla perceptohen si hipokrite dhe jo të sinqerta, kjo vetëm do t'i ndihmojë një qeverie mos-përbushëse që fajin t'ia bartë partnerëve të saj evropian.

Aderimi në BE ka qenë gjithmonë proces politik, jo vetëm teknik, por duhet vënë limite në interpretimet, në mënyrë që kandidatët (potencial) të mos ndjehen të tradhtuar. Një nga këto limite është se rregullat e lojës nuk ndërrohen gjatë lojës. Po, Kosova është duke kërkuar anëtarësi në një BE tjetër prej asaj në të cilën kanë hyrë Polonia, Rumania, apo edhe Kroacia. Po, ajo mund vetëm ta pranojë ofertën ekzistuese apo të largohet. Por oferta nuk guxon të jetë e paqartë, apo të ndryshohet në të njëjtën mënyrë si p.sh. kompanitë e huaja kanë bërë shprehje që të ndryshojnë kontratat, koston, dhe klauzolat për punë infrastrukturë në Kosovë dhe përreth saj! Popujt të cilët kanë jetuar kohë të gjatë të pushtuar bëhen oportunistë dhe i

përshtaten me profesionalizëm përdorimit të mjeteve të patronëve të vet kundër tyre, kështu që nëse Kosova është e udhëhequr nga korrupsioni, atëherë së paku mos ta mësojmë këtë vend me format e reja të përdorimit të tij dhe gati t'u ofrojmë bazë morale për të bërë një gjë të tillë duke aplikuar në vetë standarde të dyfishta. Përveç kësaj, kriza aktuale në Evropë ka ekspozuar hipokrizinë e pandarë të identifikimit të korrupsionit, legjislacionit të papërshtatshëm, dhe ekonomisë së brishtë si arsye për t'i mbajtur shtetet aspiruese tek dera, përderisa tradhtarët dalin të jenë anëtarët e vjetër, me shpenzimet e tyre të tepruara dhe llogari-mbajtje të rreme. Natyrisht, këtu del se nuk është problemi tek ndryshimi i kriterëve por tek zotësia që t'i obligojnë ato tek të gjitha shtetet-anëtare.

* * *

Pa dyshim, Kosova ka çdo të drejtë të jetë e irrituar me pavendosmërinë e BE-së. Të mbash një dialog të hapur me Beogradin, nëpërmjet të cilit Brukseli u kërkon të dy palëve të jenë pjesë e zgjidhjes e jo e problemit është në të vërtetë forma më e mirë për të gjetur zgjidhje të pranueshme – por njëkohësisht është tmerrësisht e dhembshme dhe e vështirë për të dyja. **Nëse realizohet me sukses, kjo do të jetë një fitore aq e rëndësishme historike sa që mund të qojë drejt ribrendimit të tërë rajonit,** nga të qenit një dhimbje kokë në të bërit model ku ish-luftëtarët do të shiheshin si vizionarët që kanë braktisur dallimet mes vete për hir të mirëqenies së popujve të tyre; dhe **drejt rehabilitimit të gjithë idesë evropiane dhe asaj të zgjerimit** si një shkop magjik i cili mund të sjellë paqe dhe progres.

Kjo është saktësisht arsyeja pse **Kosova duhet të përqafojë perspektivën evropiane, instrumentet dhe parimet e saj me më shumë energji, e posaçërisht tani kur BE-ja duket të jetë në dyshim.** Edhe pse mund të



Takimi i delegacionit të gjerë rumun të ftuar nga KFOS me Zëvendësministrin e Punëve të Jashtme, Petrit Selimi, tetor 2011

ndodh që gjërat mos të realizohen ashtu siç Kosova ka shpresuar, Prishtina nuk ka zgjidhje tjetër pos ta bind Evropën që të mos shkëputet, duke u bërë shembull i gjallë i efektit intensiv transformues që aspiratat evropiane kanë pasur në tërë rajonin. Dhe në këtë, interesat e saj ndahen me ato të Serbisë dhe pjesës tjetër të Ballkanit – dhe kjo në vete bëhet edhe një shkak për të punuar se bashku, e jo në qëllime të kundërta.

Sikur në krizat e lidhjeve, Prishtina duhet të qëndrojë zonjë e vërtetë dhe të dëshmojë se me të vërtetë beson në martesën dhe t'ia jap Evropës gjithë dashurinë e saj – të pakushtëzuar – me shpresë se kjo me kohë do t'i kthehet në të njëjtën masë. Dosido, Kosova nuk ka çfarë të humb në këtë proces dhe kjo ka gjasa të shpaguhet më shumë se sa një qëndrim i stilit "do ta vras veten nëse nuk me do." Këshilla e njëjtë i është dhënë edhe Mikhail Saakashvilit në Samitin e NATO-s në Bukuresht në prill 2008 kur ai

kërcënoi se Gjeorgjia mund të bjerë në qoftë se i refuzohet udhërrëfyesi për aderim. Që nga ajo kohë, Gjeorgjia është bërë një nga vendet më miqësore për investimet në botë, e përqafuar gjerësisht nga bizneset perëndimore. Megjithatë, Kosovës do t'i duhet shumë ndihmë nga miqtë e saj në mënyrë që të mbetet e përkushtuar në rrethana të tilla – ndërsa gjasat e saj për sukses do jenë të vogla përderisa ajo nuk merr rezultate konkrete nga BE-ja. Ngecja dhe konflikti etnik që po zihen ngadalë prapë në Maqedoni janë dëshmi se çfarë neglizhenca mund të i bëjë këtij rajoni.

Dy kategori shtetesh mund të luajnë rol veçanërisht të rëndësishëm: **fqinjët e Kosovës në Evropën Qendrore dhe Lindore të cilët vetë kanë përjetuar tranzicionin**, përfshirë këtu si sfidat ashtu edhe shpërblimet, dhe **pesë shtetet mos-njohëse të BE-së**, të cilat mund të mbajnë pozicionet e tyre por në asnjë mënyrë nuk duhet t'ua

mohojnë Kosovarëve qasjen në reforma dhe zhvillim. Vetë vendi im, Rumania, i takon të dy kategorive dhe e kupton shumë mire si rrezikun ashtu edhe realitetin e standardeve të dyfishta (në të njëjtën mënyrë si politikisht po i bllokohet hyrja në Schengen nga partitë populiste kundër-imigracionit në qeverinë holandeze, përkundër përmbushjes së të gjitha kushteve teknike) dhe të tragjedi që mund të ndodhin kur partnerët perëndimor nuk mund të vendosin dhe të formalizojnë marrëdhëniet e tyre: në Gusht 2008, Gjeorgjia e refuzuar (anëtarësimi i të cilës në NATO Bukureshti e kishte mbështetur plotësisht katër muaj më parë) e gjeti veten në luftë me Rusinë...

(Oana Popescu është analiste politike dhe gazetare, themeluese e Global Focus Centre dhe drejtore të Qendrës për Parandalim Konfliktesh dhe Paralajmërim të Hershëm në Bukuresht, Rumani.)

SPANJA DHE KOSOVA: HAPAT PËR NJOHJE NË TË ARDHMEN NË KORNIZË TË INTEGRIMIT EVROPIAN

Ruth Ferrero-Turrión
maj 2012



Panel diskutimi nga konferenca Kosova Thërret, organizuar më 20 Prill, 2012 nga KFOS, MPJ, British Council, ambasada britaneze, dhe KPI. nga e majta: Cristi Ghinea (CRPE, Rumania), Oana Popescu (Global Focus, Rumania), Venera Hajrullahu (KCSF, Kosovë), George Tiugea (Ovidiu Sincai Institute, Rumania), dhe Ruth Ferrero-Turrión (Universidad Complutense, Spanjë)

Kur përmendet Kosova në Spanjë, për çfarëdo arsye, në përgjithësi shfaqen dy ide në bisedë: pavarësia dhe stereotipat negative. Pavarësia për arsye se opinioni publik e din që Kosova e ka shpallur pavarësinë e saj para disa viteve; stereotipat për arsye se njerëzit automatikisht e bëjnë lidhjen ndërmjet krimit të organizuar dhe shqiptarëve të Kosovës. Duke i pasur parasysh gjërat e thëna më sipër, është lehtë të arrihet në përfundim që opinioni i gjerë publik në Spanjë nuk e kujton aspak shtypjen e bërë nga trupat dhe milicia serbe kundër kosovarëve pas vitit 1998 ose historinë e imigrimit të shqiptarëve të Kosovës gjatë shekullit të kaluar. Përveç kësaj, disa spanjollë mund të mos japin përgjigje të saktë në pyetjen "A e dini nëse Spanja e ka njohur Kosovën?".

Këto janë premisat sipas të cilave autoritetet spanjolle ballafaqohen me njohjen e Kosovës: një mungesë e plotë e njohurisë lidhur me kontekstin e ish-Jugosllavisë dhe historisë së saj. Natyrisht, në procesin vendimmarrës nuk ndikon vetëm opinioni publik por po ashtu edhe faktorët e tjerë të cilët mund ta sqarojnë qëndrimin e tillë të rreptë të administratës spanjolle lidhur me këtë çështje. Arsyet dhe analizat e dhëna mund të ndihmojnë për ta kuptuar më mirë qëndrimin e Spanjës.

Spanja në mesin e pesë shteteve anëtare evropiane mos-njohëse

Aktualisht, 90 shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara (46,6%), 60% e vendeve të OECD, 70% e anëtarëve të

Këshillit të Evropës dhe 80% e anëtarëve të Bashkimit Evropian, veç FMN-së dhe Bankës Botërore, e kanë njohur Kosovën si shtet të pavarur. Në kuadër të Bashkimit Evropian, vetëm pesë vende nuk e kanë njohur zyrtarisht shtetin e ri të krijuar më 2008. Në mesin e vendeve kryesore mos-njohëse, mund t'i gjejmë vendet e ashtuquajtura BRICS (Brazil, Rusia, India, Kina dhe Afrika e Jugut), Vatikani dhe disa vende të Afrikës Veriore siç është Maroku, Algjeria ose Egjipti në mes tjerash. Në kuadër të rajonit, pjesa më e madhe e shteteve të Ballkanit Perëndimor, me përjashtim të Bosnjës, të Serbisë dhe të Greqisë, e kanë njohur shtetin e ri. Madje edhe pasi që Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë shpalli ligjshmërinë e procesit të pavarësisë, disa shtete sovrane mbajtën qëndrimin e tyre fillestar, dhe opinioni publik global ende mbetet i ndarë.

Në shumicën e rasteve, qëndrimi i një vendi mund të sqarohet si pasojë e çështjeve të brendshme dhe të konflikteve të pazgjidhura, por madje edhe pasi që është thënë në dokumentet zyrtare (KB, BE, etj.) është një shembull "i veçantë dhe sui generis", ekziston një ndjenjë e përgjithshme e mosbesimit në lidhje me doktrinën e "bashkësisë ndërkombëtare" në këto çështje. Kjo vlen posaçërisht për Ballkanin Perëndimor, ku nuk ka pasur kurrë qëndrim të qartë për këto vende që nga fillimi i ndodhjes së ndryshimeve në vitet e nëntëdhjeta.

Dallimet me shtetet e tjera mos-njohëse

Duke u përqendruar vetëm në vendet mos-njohëse të Bashkimit Evropian, edhe pse ato nuk munden vërtetë të analizohen si grup homogjen, është lehtë të vërehet se prej të pesë vendeve Spanja mund të jetë më e pazakonshme. Kjo ndodhë për shkak të pesë dallimeve kryesore krahasuar me pjesën tjetër të grupit.

1. – *Spanja është e vetmja që nuk gjendet në rajon.* Edhe pse është thënë që Spanja dhe Greqia janë anëtarët e vetme të BE15 që nuk e njohin Kosovën, një faktor më relevant është që Spanja është e vetmja që kurrë nuk ka pasur konflikt të shkaktuar nga shpërbërja e Perandorisë pas Luftës së Parë Botërore: Greqia, Qiproja, Sllovakia dhe Rumania kanë qenë të gjitha të përfshira në ngjarje të tilla dhe historikisht kujtesa luan një rol të rëndësishëm në disa vendim politike, në veçanti kur këto lidhen me pretendimet territoriale.

2. – *Spanja nuk ka pasur kurrë interesim të drejtpërdrejtë politik, ekonomik, tregtar ose madje kulturor në Ballkan.* Për fat të keq, Spanja nuk i ka kushtuar kurrë vëmendje kësaj pjese të Evropës, duke ia lënë gjithë ndikimin Italisë, Gjermanisë, Britanisë së Madhe ose Francës. Përqendrimi kryesor i vendit në këto fusha ka qenë i orientuar historikisht drejt Amerikës Latine, vendeve të Afrikës Veriore dhe Bashkimit Evropian.



3. – *Spanja si vend mos-njohës*. Qëndrimi spanjoll nuk mund të sqarohet pa i marrë parasysh disa çështje të *realpolitikës* së brendshme. Së pari, një arsye pse socialistët morën pushtetin më 2004 ishte për shkak të mbrojtjes së rreptë që ia bënë të drejtës ndërkombëtare dhe shkeljes së saj gjatë invadimit të Irakut³. Mandati suprem i Kombeve të Bashkuara në konfliktet ndërkombëtare/rajonale ishte njëra prej *motove* kryesore gjatë rrjedhës së fushatës zgjedhore. Ky qëndrim i ashpër dhe interpretimi i të drejtës ndërkombëtare ishte personifikuar në ish-ministrin e punëve të jashtme, Miguel Angel Moratinos.

Megjithatë, madje edhe pse Spanja ishte aktore aktive kundër njohjes së

Kosovës, gjatë presidencës spanjolle të Bashkimit Evropian, në takimin e Sarajevës, ku ishin të pranishme pranë të njëjtës tavolinë të gjitha palët, u propozua një qasje fleksibile lidhur me këtë çështje. Përveç kësaj, vlen të përmendet deklarata e Juan Fernando López-Aguilar më 2009, kur e hapi derën për njohjen e Kosovës duke u bazuar në arsye të ngjashme të njohjes së shtetit të Izraelit pas 40 vjetëve të mos-njohjes. Pas njohjes, të dy vendet vendosën marrëdhënie të menjëhershme diplomatike.⁴

Pas ndryshimeve politike që ndodhën në Spanjë në nëntor 2012, nuk mund të presim kushte më të favorshme për njohje. Partia Popullore, e cila është në pushtet aktualisht, ishte partia e parë

politike në Spanjë që e refuzoi pavarësinë. Për më tepër, nuk janë vetëm elitat e partisë ato që e kundërshtojnë pavarësinë e Kosovës; përkrahësit e saj janë plotësisht kundër çdo procesi të pavarësisë të çfarëdo lloji. Ky qëndrim përkrahet po ashtu nga gazetatat e djathta dhe të djathta të qendrës në vend: La Razón, ABC, dhe El Mundo. Partia Popullore tradicionalisht ka apeluar për “krenari kombëtare”, për shembull në të kaluarën gjatë ngjarjeve të Ishullit Perejil më 2002 nën presidencën e Aznarit dhe së voni në rastin e konfliktit të Repsol YPF me Argjentinën.

Përveç kësaj, ne duhet ta kujtojmë

³ Vaquer, Jordi (2012), Qëndrimi i Spanjës për Kosovën, në Kosova thërret, faqe. 12-13.

⁴ ABC, 14 maj 2009

deklaratën e dhënë nga ministri aktual për punë të jashtme, José García Margallo, më 2009 një gazete kosovare (Koha e Kosovës), ku e përmendi që Spanja nuk e njeh Kosovën për shkak të "parimeve lidhur me komunitetet autonome baske dhe katalonase të Spanjës, edhe pse situata nuk është e krahaseshme". Ai shtoi po ashtu që përkundër mos-njohjes, Spanja do ta mbështeste zhvillimin e Kosovës. Kjo ishte njëra prej herëve të para që një çështje e brendshme po përmendej nga një politikan spanjoll si arsye për mos-njohjen e Kosovës.

Gjatë një seance të paradokohshme në parlament më 14 mars, kryeministri i Spanjës Mariano Rajoy, duke ju përgjigjur nacionalistëve Catalans of Convergencia i Unio, tha që qëndrimi i Spanjës ndaj Kosovës nuk do të ndryshojë. Rajoy arsyetoi këtë vendim "për shkak të faktit që kjo është pozita më e përshtatshme për pjesën më të madhe të popullit spanjoll".⁵

Kështu, tani mund të përfundojmë që dy arsyet kryesore që kanë ndikuar në mos-njohjen e Kosovës nga ana e Spanjës: së pari, qëndrimi i Spanjës si "kalorës mbrojtës" i së drejtës ndërkom-bëtare, që i jep Qeverisë Zapatero një pjesë të legjitimitetit të saj, dhe së dyti "frika nga sëmundja ngjyëse" për shkak të konfliktit të ngrirë me nacionalitetet historike të Spanjës.

4. - *Çështja e Kosovës nuk është në agjendën politike të Qeverisë spanjolle.* Tani për tani Kosova nuk është përfshirë si prioritet në agjendën e qeverisë spanjolle, e cila aktualisht është e përqendruar në recesion, në papunësinë e madhe në vend dhe në krizën ekonomike. Disa parti nacionaliste nga Galicia, Shteti Bask, dhe Kat alonia ende e kanë Kosovën në agjendën e tyre, por vetëm në pozitë më të ulët, dhe ato e ngritin çështjen rregullisht në Parlament.

5. - *Spanja, si rezultat i krizës së*

lartpërmendur ekonomike dhe rrjedhës gjithnjë e më të madhe të migrimit nga shtetet e reja anëtare, ndoshta është në pozitë ta vonojë zgjerimin drejt Ballkanit Perëndimor. Është e mundur që Spanja mund t'i bashkohet lëvizjes në BE, të udhëhequr nga qeveria holandeze dhe ajo franceze (ky mund të jetë ndryshim nëse qeveri të reja vijnë në pushtet në këto vende), që të imponojnë kufizime në zonën Schengen për qytetarët e shteteve të reja anëtare. Nuk duhet të harrojmë që madje edhe Gjermania hezitonte t'i përfundonte masat kalimtare që ju janë imponuar shtetasve të shteteve të reja anëtare dhe Spanja i vendosi ato sërish për rumunët korrikun e kaluar.

Spanja në lidhje me Kosovën

Sa i përket raportit spanjoll-kosovar, çështja e parë që duhet të theksohet është se Spanja nuk ka asgjë kundër Kosovës si të tillë. Nuk ekzistojnë paragjykime të trilluara kundër qytetarëve kosovarë të asnjërit nacionalitet dhe madje as kundër territorit të shtetit si të tillë. Problemi kryesor që Spanja ka me pavarësinë e Kosovës ka të bëjë me çështjen e "procedurës". Mënyra si është vendosur pavarësia – në mënyrë të njëanshme – pa dyshim që brengosë autoritetet spanjolle, edhe pse dokumentet zyrtare evropiane flasin për një rast *sui generis*.

Duke e pasur parasysh këtë, një marrëveshje ndërmjet Serbisë dhe Kosovës do të shihej në mënyrë shumë pozitive dhe është e mundur që Spanja do të ishte proaktive në mbështetjen e një qasjeje të këtillë. Në këtë kuptim, integrimi më i madh rajonal, jo vetëm politik por po ashtu edhe social, logjistik, tregtar, etj. do ta shtonte trysinë në vendet mos-njohëse brenda institucioneve të Bashkimit Evropian. Të treguarit shteteve anëtare se ato konflikte të vjetra i takojnë të kaluarës dhe që bashkëpunimi rajonal është i mundur, do të ishte një vlerë e rëndësishme. Disa shembuj do të ishin marrëdhëniet më të lirshme tregtare ose rrjetet më të mira të

komunikimit ndërmjet kryeqyteteve kryesore në rajon.

Përqendrim më i madh në kushtetutën e Kosovës që të përfshijë si kombësi kushtetuese jo vetëm shqiptarët e Kosovës por po ashtu edhe të gjitha pakicat në territor, do të ndihmonte në zbatimin më efektiv të sundimit të ligjit dhe të të drejtave të pakicave, të cilat do të vepronin si instrument ndërmjetësimi ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe Kosovës dhe vendeve mos-njohëse evropiane. Përveç kësaj, ky zbatim efektiv i sundimit të ligjit do ta ndihmonte efikasitetin në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Përfundim

Në mënyrë që të kemi një qasje praktike ndaj zhvillimit të Kosovës, të gjithë aktorët (Kosova, Serbia dhe vendet mos-njohëse evropiane) duhet të veprojnë në mënyrë shumë pragmatike. Kjo nënkupton që do të nevojitet qasje kreative drejt Bashkimit Evropian, duke e pasur parasysh një vonesë shumë të mundshme të zgjerimit, ashtu si theksoi Kancelarja Merkel më 2009. Sipas të gjitha gjasave, zgjerimi nuk do të ndodhë para vitit 2020. Megjithatë, kjo vonesë do të mund të shfrytëzohej si mundësi në rajon për t'iu dhënë kohë të mjaftueshme të gjitha vendeve në territor për të ndërtuar ura ndërmjet njëra tjetrës.

Qartazi, kjo nuk do të paraqiste njohje të shpejtë, por të gjitha proceset e njëanshme të pavarësisë gjithmonë kanë zgjatur më shumë. Pavarësia e parë e Kosovës është bërë më 1991, vetëm një vend e njohu atë: Shqipëria. Pas shpalljes së dytë të pavarësisë më 2008, 22 shtete anëtare evropiane dhe 90 anëtarë të Kombeve të Bashkuara e kanë njohur Kosovën.

(Ruth Ferrero-Turrión ligjëron në Institutin për Studime Ndërkombëtare, në Universidad Complutense de Madrid.)

⁵ La Vanguardia, 14 mars 2012.

POLITIKA E JASHTME E KOSOVËS

Tim Judah

prill 2012



Kur bëhet fjalë për armatat, ato gjithmonë thonë se pasi kanë mësuar të gjitha mësimet nga gjitha të bërat e gabueshme më parë, tani janë të gatshme të luftojnë luftën e fundit. Natyrisht, rrethanat në ndërkohë ndryshojnë, armiku ndryshon, ndërsa armatat mbeten të zënë hapin. O sa më e lehtë do të ishte sikur Al Kaida t'i kishte sulmuar Shtetet e Bashkuara me 11 shtator me tanke në fushën qendrore të Gjermanisë. Ndërsa sa i përket politikës së jashtme të Kosovës, a bëhet që Kosova, e cila ka ndërtuar ministrinë e jashtme nga zeroja, të jetë e gatshme që tani të marrë botën e që nga viti i kaluar?

Para pavarësisë, në Kosovë është menduar pak për politikën e jashtme të shtetit të ardhshëm. Kjo ishte e kuptueshme. Pas të gjithave, edhe në Skoci, shoqëri shumë me e pasur dhe me komplekse, e cila me shumë gjasa do të mbajë referendumin për pavarësi dikur në vjeshtën e 2014-ës, është menduar pak për politikën e jashtme dhe të mbrojtjes deri më tani. Pse të mendohet për diçka që nuk është relevante, dhe për Kosovën deri në vitin 2008, nuk ishte dhunti e juaj sidoqoftë?

Por e kaluara është një shtet tjetër. Tani që Kosova është shtet, edhe pse ju pëlqeu apo jo, është tjetër nga gjithë fqinjët e saj. Prandaj, për këtë arsye propozoj që duhet menduar ndryshe edhe për sa i përket politikës së jashtme dhe çfarë mund të bëj me ajo mundësitë e saj të kufizuara.

Që nga pavarësia, politika e jashtme është dalluar me dy faza të dallueshme. E para filloi me pavarësinë dhe zgjati deri në shkurt 2011. Kjo ishte periudha e kujdesit të Skënder Hysenit si ministër i jashtëm. Periudha e dytë ishte ajo e kohëmbajtjes së Enver Hoxhaj. Natyrisht, prioriteti i parë dhe mbizotërues që nga 2008 ka qenë në fakt ndërtimi i

ministrisë së jashtme. E dyta, çka ka kaluar si politikë e jashtme në të vërtetë është reduktuar në një politikë qendrore, e që ka qenë sigurimi i njohjeve për shtetin e ri.

Periudha fillestare ka qenë shënuar nga një varësi masive në ndihmën nga shtetet miqësore dhe në ngurrim që këtë betejë ta bartin në tërë planetin, pa marrë parasysh sa e vështirë do të ishte. Krahasoni këtë me energjinë e Vuk Jeremiqit, ministrin e jashtëm të Serbisë, i cili pjesën më të madhe të jetës së vet në këtë kohë e kaloi në fluturim, duke vizituar ministrinë e jashtme në mbarë botën për t'i bindur ata kundër njohjes së Kosovës. Këtu ai ka bërë secilën përpjekje, përfshirë edhe lojën nostalgjinë për periudhën e mos-inkuadrimit.

Gjatë udhëtimeve të tij, Z. Jeremiq theksonte se ministrat e jashtëm që kishte vizituar shpesh i thonin se kishin rënë nën presione të mëdha nga Shtetet e Bashkuara, Mbretëria e bashkuar, dhe shtete tjera mike të Kosovës që të njohin shtetin e ri, ndërsa Rusia, Kina, dhe shtetet mike të Serbisë nuk kishin bërë asgjë të ngjashme në kuptim të diplomacisë aktive në emër të Serbisë. Kështu që Serbia fitoi shumë respekt në disa drejtime duke luajtur Asteriksin i cili ishte ngritur kundër perandorisë amerikane.

Menjëherë pas fillimit të fushatës, e cila inkudroi edhe diplomacinë që qoi deri tek vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë përndryshe shkatërrimtar për Serbinë, çka në fakt befasoi Serbët ishte puna të cilën ata bënë në Kosovë u shpagoi dividendë diku tjetër, e posaçërisht për sa i përket tregtisë, dhe atë veçanërisht në sektorin e sigurisë. Por me shumë se kaq, Z. Jeremiq mund të bëhet presidenti i radhës i Asamblesë së Përgjithshme të

Kombeve të Bashkuara, bazuar në votat e fituara nga shtetet me ministrat e jashtëm të të cilave rreth Kosovës. Pos kësaj, në vitin 2015 Serbia do të jetë kryesuese e OSBE-së. A mund Kosova të mësojë diçka nga gjithë kjo?

Do të mund të argumentohet se lufta diplomatike e Serbisë kundër Kosovës është, për një periudhë të gjatë e paracaktuar të përfundojë keq përkundër njohjeve të ngadalshme që do të pasojnë. Megjithatë, fakti se Rusia, Kina, Brazili, Kina, etj janë objekte të palëvizshme sa i përket njohjes, se paku për një të ardhme të parashikueshme, ashtu siç janë edhe pesë shtetet mos-njohëse të BE-së.

Prandaj, çfarë mund të bëjë Kosova? Pikësepari, ajo tashmë është duke bërë diçka. Pas një periudhe relative të pasivitetit, periudha Hoxhaj sigurisht se ka qenë shumë më aktive dhe më pak e varur nga miqtë. Dhe jo vetëm kaq. Ajo ka lëvizur, ashtu siç janë zgjeruar kapacitetet të përfshijë edhe fusha tjera të rëndësishme, siç është diplomacia publike. Kjo ka nënkuptuar konferencat të cilat kanë sjellë njerëz nga shtetet mos-njohëse të Kosovës dhe angazhimin, ku ka qenë i mundshëm, ta sjellë Kosovën në organizatat multilaterale. Ribrendimi i Kosovës, e cila në përgjithësi ka imazh të varfër jashtë vendit, ka qenë poashtu prioritet.

Por si në fakt e sheh ministria rolin e saj? Sipas uebfaqes së saj roli i saj është "të mbrojtë interesat e Kosovës karshi shteteve tjera dhe organizatave ndërkombëtare." Prioritetet e saj janë gati jashtëzakonisht solide, të arsyeshme, dhe të parashikueshme. Ato përfshijnë njohjet e reja, integrimin evropian, anëtarësimin në NATO, "vazhdimin e raporteve të afërta dhe speciale" me SHBA-të, e kështu me



radhë. Me fjalë tjera, Kosova dëshiron të jetë si të gjithë fëmijët tjerë në fushëllojë.

Fëmijët tjerë në këtë fushëllojë të veçantë përbëhen nga ish-jugosllavët plus Shqipëria. Një herë dy shtete, tash tetë. Por është fakt se, për një të ardhme të parashikueshme, Kosova nuk do të mund të jetë e njëjtë me shtatë të tjerat. Ajo nuk mund të jetë anëtare e Kombeve të Bashkuara, nuk e kontrollon plotësisht territorin e saj, ndërsa fqinji i saj më i madh mbetet armiqësor. Sa i përket Kombeve të Bashkuara dhe vetos ruse dhe kineze, të cilat duke përjashtuar çdo gjë tjetër të paparashikueshme do të hiqen vetëm kur Serbia ta njoh Kosovën, që dëshmon njëkohësisht se ka ca të vërtetë në deklaratimet serbe (edhe pse shumë më pak se që Serbët duan të besojnë), se e vetmja njohje që me të vërtetë do të bëj ndryshim në Kosovë, është njohja nga Serbia. Dhe kjo nuk është duke ardhur në një të ardhme të afërt.

Natyrisht, politika e jashtme është gjithmonë njësi e një vazhdimësie e cila fillon me politikën vendore, e cila në rastin e Kosovës, është posaçërisht e vështirë për t'u definuar se ku bërja e politikës se

brendshme zbehet në bërjen e politikës së jashtme. A është ballafaqimi me veriun politikë e brendshme apo çështje ndërkombëtare? Shikoni, është qartazi që të dyja. Kur Kosova u pajtua me 24 shkurt për bisedimet nën mbështetjen e Bashkimit Evropian për marrëveshjen Kosovo*, kjo kishte edhe shtrirje vendore, por po ashtu kishte lidhje të drejtpërdrejta me fillimin e studimit të fizibilitetit të BE-së, dhe ishte pjesë e politikës për fillimin e liberalizimit të vizave për kosovarët për shtetet Shengen.

Në të njëjtën mënyrë, kur Edita Tahiri si kryenegociatore bisedon me Serbinë në raundin e radhës mbi energjinë dhe telekomunikacionin, do të jetë e vështirë të thuhet nëse flet për politikë të jashtme apo të brendshme. Por sidoqoftë, ajo çka duhet të kemi parasysh është fakti i thjeshtë se Kosova, në kufij të definuar qartë dhe e njohur nga tërë bota nuk do të ndodhë në një të ardhme të afërt. Konflikti i Kosovës me Serbinë dhe çështja e veriut do të vazhdojnë të menaxhohen për vitet që vijnë më shumë se sa të zgjidhen.

Prandaj këtë duhet ta analizojmë me vëmendje. Si mundet Kosova* të lëviz drejt

Kosova+ dhe çfarë në këtë rast mund të jetë roli i politikës së jashtme?

Çështja në të vërtetë është se Kosova nuk kalon lehtë. Larg faktit që ka kryeministrin të akuzuar për krime të urryera, ajo është e varfër, e rënduar nga papunësia, jo në ndonjë pozicion strategjik, e rënduar me trashëgiminë e korrupsionit, dhe me një industri të vogël funksionale. Të gjitha këto problem, dhe shumë të tjera, kuptohen shumë mirë. Kjo nuk është një lajm. Për politikë të jashtme të suksesshme, Kosovës do t'i duhet edhe politikë vendore e suksesshme, sepse njëra nuk mund të jetë e suksesshme pa tjetrën.

Në kuadër të politikës së jashtme, deri më tani Kosova ka punuar drejtë ndërtimit të shtetit normal, re njohur dhe të mirëpritu nga të gjithë si i barabartë. Kjo duhet të mbetet prioritet i politikës së jashtme, por mund të ndodh të vijmë deri në pikën në të cilën vazhdimi i punës në këtë *prioritet si kryesori* do të nënkuptojë angazhim në prioritet i cili sjell gjithnjë e më pak përfitim. Natyrisht se do të ishte e shkëlqyeshme sikur Trinidad dhe Tobago të njohin Kosovën, por ndoshta resurset që përdoren në sigurimin e kësaj njohjeje, që nga tani do të mund të përdoren me mirë diku tjetër.

Ja disa pika për t'i shoshitur. Shtetet e Bashkuara janë të gjymtuara nga borxhet dhe në rënie relative. BE-ja është në periudhë të ngecjes dhe të vetë-analizimit. Euroja është në krizë.

Kryengritjet arabe janë duke ndryshuar gjeopolitikën botërore. Gazi nga shisti argjilor dhe rëra e naftës janë duke ndryshuar pasqyrën botërore të energjisë. Fuqia he ndikimi në botë po lëvizin drejt lindjes. Siguria kibernetike është një prioritet i politikës së jashtme të shteteve kryesore gjithnjë në rritje.

Politika globale është duke ndryshuar strukturën, ndërsa teknologjia është shtytësi kryesor i ndryshimeve. Shtete mbeten të rëndësishme, por rëndësia e tyre është në rënie. Parag Khanna, njëri ndër mendimtarët më të shquar aktual të marrëdhënieve ndërkombëtare, parashtron se jemi duke lëvizur drejt një bote në të cilën marrëdhëniet ndërkombëtare i ngjasojnë më shumë kohës së mesjetës se sa sistemit uestfalian. Qytetet e mëdha

janë të rëndësishme, kompanitë e mëdha janë të rëndësishme, dhe për këtë arsye "diplomacia nuk ka të bëjë vetëm me shtetet, fuqia nuk ka të bëjë vetëm me shtetet, nuk ka të bëjë vetëm me sovranitetin, po ka të bëjë me autoritetin." Ministria e Jashtme e Kosovës ka buxhet rreth €16.2 dhe gjithsej rreth 222 diplomat dhe shërbyes. Në kontekstin e përgjithshëm të situatës, kjo është mikroskopike. Prandaj, tash pyetja që duhet të shtrohet është nëse resurset e Kosovës janë duke u përdorur deri në maksimum të përparësive. Ndoshta është koha për të menduar fazën e tretë në politikën e jashtme të post-pavarësisë. Në këtë periudhë, Kosova do të mund të zvogëlonte përqendrimin në ambasada, ngritjen e flamurit kudo nëpër botë e kështu me radhë, pasi që Kosova, siç e kam cekur dhe më lartë, është tjetër, dhe për këtë arsye do të duhej të bënte po ashtu diçka tjetër.

Khanna thotë se "në vend se të përqendrohet në diplomacinë uestfaliane (apo të shkollës së vjetër) të njohjes dhe ambasadave" Kosova, Sudani jugor, Azauadi, dhe kombet e tjera të varfra, pa dalje në det, dhe rishtazi të pavarura duhet të përqendrohen shumë më tepër në rritjen e investimeve direkte nga kompani multinationale të rëndësishme dhe me ndikim, dhe kur është e nevojshme në marrëdhënie të maskuara ushtarake, më shumë se sa në ceremonialet e protokollit diplomatik. Sovraniteti de facto është shembulli më i mirë për sovranitetin de jure.

Çfarë do të mund të thoshte kjo? Paramendoni një njësi të re për mendim strategjik në zemër të ministrisë së jashtme, të ngarkuar me planifikim ashtu siç propozon Khanna. Ajo do të mund të vendoste se përderisa ambasadat në Pragë dhe Budapest janë të mira, paraja do të mund të shpenzohej më mirë në diçka tjetër – si për shembull duke akredituar ambasadorë kosovarë për tregti dhe investime e të vendosur në Seul dhe Shanghai. Kina mund të mos e njoh Kosovën, por realiteti është se paraja qon peshë e edhe ashtu Kina është njëri prej partnerëve më të mëdhenj tregtar të Kosovës.

Sot, Behxhet Pacolli, zëvendës kryeministër, shëtit botën duke u munduar të i bind

shtetet që ta njohin Kosovën. Por, z. Pacolli ka edhe një angazhim tjetër. Në të kaluarën, si magnat në industrinë e ndërtimtarisë, ai ka dërguar Kosovarë të punojnë në Kazakistan nën kontrata ndërtimore të fituara nga kompania e tij. Ndoshta z. Pacolli do të mund të punonte në këtë koncept dhe ta zhvillonte me tutje si p.sh. të gjejë punë për gastarbajterët e gjysmë të kualifikuar dhe të kualifikuar të së ardhmes. Me njohje nga 89 shtete, më shumë vende pune janë më të rëndësishme për Kosovarët si individ dhe shtet se njohja nga bregu i Fildishtë.

Për sa i përket ushtrisë, ashtu siç propozon Khanna, ndoshta Kosovarët do të mund të ofronin njësite ushtarake për nevojat e shteteve mike. Nëse është e pranueshme për nepalezët të ofrojnë ushtarë Ghurka për Mbretërinë e Bashkuar në shekullin 21, ashtu siç kanë për 200 vjet me radhë, atëherë pse Kosova nuk do të mund ta bënte të njëjtën, në formë të hapur apo të mbyllur për shembull për Shtetet e Bashkuara?

Çfarë thoni për zvogëlimin e një ambassade, në të cilën një anëtar besnik partie shpërblehet me rahatinë e pozitës së ambasadorit, dhe ndërsa të emërohet nëse jo një ambasador tek Apple (e cila ka \$1 miliard në bankë pa borxhe) atëherë të emërohet një ambasador i cili do të ngarkohet me vizita kompanive të mëdha me qëllim që të sigurojë investime dhe ta vendosë Kosovën në hartat e tyre mentale? Kosova ka mjaft njerëz të kualifikuar, në vend dhe në diasporë, të cilët do të vinin në shtëpi po që se kanë vende pune. Edhe një investim i vogël në teknologji të lartë, në nano-teknologji, apo bio-teknologji do të siguronte një shpërthim të jashtëzakonshëm të imazhit të Kosovës, e mos të flasim për buxhetin.

Ndërsa diaspora mbetet një burim tjetër i pashfrytëzuar të cilën hartuesit e politikës së jashtme do të duheshin prekur. Është e vërtetë, në kuptim të përgjithshëm, se diaspora Kosovare nuk është ndër më të pasurat. Megjithatë, janë të rinjtë kosovar, të lindur o në Kosovë o në diasporë, e që mbajnë një vend pune të mire në një kompani farmaceutike në Zvicër, apo në një kompani të veglave makinerie në Gjermani, të cilët duhen ftuar të jenë pjesë e

bashkëbisedimeve për të ndihmuar ministrinë në identifikimin e njerëzve kyç e që mund të çojnë drejt investimeve të mundshme.

Ndoshta njësia e mendimit strategjik do të mund të hartonte forma të reja të qasjes në rajon të cilat edhe pse nuk janë të realizueshme sot, do të mund të realizoheshin nëpërmjet promovimit të tyre. Me fjalë tjera, duke sajuar një profeci vetë-përmbushëse. Kosova, me më pak se 2 milion njerëz, ka po aq banorë sa edhe një dy lagje të mëdha banimi në Kinë. Por, ashtu siç Shtetet e Bashkuara varen nga Azia, Kosova do të mund të argumentonte se është "rrezja" e Ballkanit, dera lidhëse mes shteteve të Jugosferës dhe sferës shqiptare, e të cilat së bashku kanë po aq njerëz sa edhe Shanghai me rrethinë.


Natyrisht, këto ide janë ato të cilat mund të kenë apo mos kenë fare vailiditet. Por esenca është se pasi që Kosova nuk është, dhe nuk mund të jetë, shtet konvencional si fqinjët e saj, atëherë tani mund të jetë koha për një vizion të ri të politikës së jashtme i cili shkon përtej çështjes se njohjeve dhe në të cilin diplomatët mësojnë zotësi të reja për botën e re. Në betejat diplomatike kundër Kosovës, Vuk Jeremiqi e pat i kuptuar se si lojtar i vogël në skenën botërore, Serbia kishte nevojë të zë përparësi kudo që kishte mundësi, dhe mos ta holloj energjinë e saj duke u munduar ta luajë rol në ato fusha politikash në të cilat nuk do të mund të kishte ndikim.

Kosova tani gjendet në pikën në të cilën edhe ajo mund të luajë një version të kësaj loje, apo ta përshtatë ate për interesat dhe kapacitetet e saj. Në NATO, fjala e përdorur më së shpeshti tani është "mbrojtje e mençur" që nënkupton nxjerrjen e përfitimit maksimal nga resurset gjithnjë në zvogëlim. Një njësi e mendimit strategjik do të mund të punonte më tepër në "diplomaci të mençur" e cila merr parasysh realitetin e Kosovës dhe realitetin e botës gjithnjë në ndryshim se sa të përqendrohet mbi të gjitha në betejat diplomatike të cilat do të duhej të kishin karakterizuar vitet e para të diplomacisë kosovare.

(Tim Judah është raportues i rregullt i The Economist për Ballkanin.)

DIPLOMACIA EVOLUESE E KOSOVES

Petrir Selimi
prill 2012



Në vitet e para të pavarësisë së Kosovës, diplomacia e Kosovës u përqendrua – përveç detyrës se pashmangshme të themelimit të institucioneve funksionale për zbatim të marrëdhënieve të jashtme – në të shumtën e kohës në sigurimin e njohjeve bilaterale nga sa me shumë shtete që ishte e mundur. Dy përjashtime nga kjo ishin aplikimi i suksesshëm për anëtarësi në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në Bankën Botërore, si dhe eliminimi i sfidës ligjore Serbe karshi shpalljes se pavarësisë së Kosovës nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (me rezultatin triumfues të vitit 2012, kur GJND-ja konkludoi se shpallja e pavarësisë as nuk ishte në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare, as në kundërshtim me rezolutën 1244 të KSKB, e as me Kornizën Kushtetuese të vendosur nga UNMIK-u).

Derisa puna për sigurimin e njohjeve bilaterale do të vazhdojë edhe për një kohë të gjatë, kjo në fakt nuk duhet të jetë fokusi i vetëm i Kosovës. 90 shtete kanë njohur Kosovën formalisht; dhe ky numër është me i lartë se numri i njohjeve bilaterale formale që ka Mali i Zi, edhe pse u bë anëtar i Kombeve të Bashkuara me 2006. Nëse merren parasysh votat e marra për anëtarësim në FMN të përbëjnë njohje (edhe pse joformale) të shtetësisë së Kosovës, mund të pohohet lirshëm se Kosova konsiderohet si një shtet i pavarur nga më se gjysma, e me siguri edhe i afrohet dy të tretave, të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara (mënyra si kanë votuar shtetet individuale mbi aplikimin e Kosovës për FMN në atë kohë nuk ka

qenë e publikuar zyrtarisht, por rezultatet tani janë në dispozicion të publikut).

Përqendrimi evolues i punës tonë diplomatike është në sigurimin e përfaqësimit dhe të anëtarësisë në institucione rajonale dhe ndërkombëtare; dhe paralelisht, në diplomaci publike e cila duhet të bëjë realitetin e Kosovës me të ditur jashtë dhe e cila nuk i kundërvihet vetëm propagandës të të tjerëve.

Një zhvillim vendimtar në lehtësimin e rrugës tonë për pjesëmarrje në organizata ndërkombëtare ishte edhe marrëveshja me Serbinë e lehtësuar nga BE-ja me 24 shkurt, 2012, në të cilën Serbia u pajtua në të drejtën e Kosovës që të përfaqësohet vetë në takimet e organizatave të cilat synojnë bashkëpunimin dhe integrimin rajonal, nën emërtimin "Kosovo*," dhe se "Kosovo*" duhet të jetë palë nënshkruese për çfarëdo marrëveshje të ndonjë organizate të tillë. Pas kësaj marrëveshje, Ministri i Jashtëm i Serbisë u sul menjëherë në Strasburg që të i thotë Këshillit të Evropës se sipas tij marrëveshja nuk mbulon këtë organizatë pasi që ajo është e hapur vetëm nga "shteteve" dhe sipas një serie të konflikteve të tjera mbi interpretimin e detajuar të saj në forumet tjera rajonale. Është e qartë atëherë se zbatimi i marrëveshjes nuk do të jetë i ndershëm dhe do të ketë pengës. Sidoqoftë është e qartë se është një hap para për Kosovën.

Megjithatë, në nuk varem vetëm nga kjo marrëveshje, edhe pse na ndihmon në një kontekst të veçantë të organizatave të cilat

– përveç Serbisë – shtete tjera të cilat nuk e kanë njohur ende Kosovën kanë përfaqësim të dukshëm. Gjithashtu, ne besojmë se në jo vetëm se plotësimi i kriteret e anëtarësisë të një numri të organizatave ndërkombëtare (përveç atyre rajonale), por kemi gjasa që të marrim vota të mjaftueshme për anëtarësi. Ne presim zhvillime të rëndësishme në këtë fushë në muajt e ardhshëm.

Paralelisht, në kemi filluar një fushatë shumë më pro-aktive të diplomacisë publike për të prezantuar realitetin e Kosovës së re. Natyrisht, kjo është për të na ndihmuar në qëllimet tjera diplomatike, por po ashtu edhe qëllim në vetvete. Edhe vendet e rëndësishme dhe të vizituara shumë ndonjëherë e shohin se imazhi i tyre jashtë vendit ngec me dekada (e ndoshta edhe një shekull) prapa realitetit të ndryshëm. Për shembull, kur një shtetas britanik viziton Rusinë, ai do të hutohet nga referencat që do t'i bëhen mjegullës së Londrës, e që në fakt i detyrohen romaneve të Sherlock Hollmsit dhe smogut viktorian të shkaktuar nga thëngjilli i djegur për ngrohje, e që përfundoi me 1950tat. Nuk duhet befasuar prandaj fakti që një shtet i vogël si Kosova, që tërheq shumë pak vizitor të vuaj nga stereotipet e vjetëruara edhe pse ndoshta dikur kanë mund të jenë të vërteta; ky do të ishte rasti edhe nëse Kosova nuk do i nënshtrohej propagandës se vazhdueshme negative të Serbisë. Ashtu si është natyrisht, jo vetëm se duhet të ballafaqohemi me fushata të tillë propaganduese, por edhe me raportet e organizatave ndërkombëtare të cilat mund të jenë të sakta për nga faktet, të përcjellin korniza të mandatuara vite më parë, dhe



si rezultat i të cilave vëmendja përqendrohet në çështjet të cilat tashmë janë më pak relevant dhe nënvetëdije ofrojnë imazhe negative për vendin tej mase.

Përgjatë viteve, qeveritë Kosovare janë dashe gjithmonë të ballafaqohen me stereotipa ose propagandë negative, por deri vonë, këtë është dashur ta bëjnë gjithmonë në mbrojtje, dhe jo gjithmonë me kompetenca të duhura. Ne më nuk shohim arsye për të qenë në mbrojtje apo reaktiv. Ashtu si Prishtina

po del nga vjetërsia e epokës së UNMIK-ut (kur hyrja kryesore në ndërtesën e Qeverisë ishte rrugë zhavorri e paasfaltuar), ne jemi pranuar si një shtet evropian në një mënyrë çfarë nuk pranohehim ca vjet me parë. Është e vërtetë që Prishtina nuk është as Firence e as Venedik. Por është qytet kumbues, i cili po zhvillohet shpejtë, dhe në të cilin një mysafir rasti do të shoh se bashkëveprimi njerëzor mes zyrtarëve shtetëror dhe qytetarëve të thjeshtë, në

përgjithësi, është me i mirë se në shtetet që na rrethojnë.

Që nga vjeshta 2011, Kosova ka lansuar një seri konferencash, disa që kanë të bëjnë me Kosovën, e disa që adresojnë çështje tjera më të gjera, e që se bashku u mundësojnë formësuesve të opinioneve nga kombet tjera të na shohin vetë drejtpërdrejtë dhe të formojnë mendimet vetanake për shtetin tonë. Nga pikëpamja jonë, bukuria e kësaj qasjeje është se nuk duhet të jemi propagandistik apo tepër të ndruajtur se si e prezantojmë vetveten. Për ata të cilat kurrë nuk e kanë njohur Kosovën, apo ata të cilët e kanë vizituar shumë vite më parë, dallimi mes imazheve të formuara me parë dhe realitetin që e shohin gjithmonë do të punojë në favor tonin. Dhe principet e njëjta jemi duke i përdorur në diplomacinë digjitale.



(Petrit Selimi është Zëvendës Ministër i Punëve të Jashtme në Republikën e Kosovës)

TË MËSOSH NGA ASTERIKSI (YLLI) PËR TË ARDHMEN E NDRITSHME TË NJË FUSNOTE

Ulrike Lunaçek
prill 2012



„Ad augusta per angusta” – kjo fjalë e urtë latine mu kujtua kur e lexova ofertën e Fondacionit Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS) për ta shkruar një artikull për Magazinën e tyre Evropiane lidhur me temën: „Fusnota: e ardhmja e ndritshme e yllit”.

„Ad augusta per angusta” fjalë për fjalë mund të përkthehet si ‘deri te vendet e larta përmes rrugëve të ngushta’ ose figurativisht ‘deri te lavdia përmes provave’. Kjo fjalë e urtë është një citat i famshëm latin në librat me vizatime komike lidhur me aventurat e Asteriksit, luftëtarit të patrembur gal dhe fshatit të tij të pathyeshëm gal në kohën e luftërave të Jul Cezarit me galët.

Natyrisht, KFOS-i nuk ka kërkuar që unë të shkruaj për Asteriksin, ata kanë dashur të dinë mendimin tim lidhur me asteriksin, yllin e vogël (*), simbolin tipografik ose glifin i cili, sipas marrëveshjes së dialogut të datës 24 shkurt 2012, duhet ta shoqërojë emrin e shtetit të Kosovës dhe i referohet fusnotës tashmë (jo) të famshme. Por më lejoni që ta shfrytëzoj këtë afërsi të fjalëpërfjalshme me heroin gal Asteriksin në mënyrë që ta sqaroj të ardhmen e asteriksit (yllit).

„Ad augusta per angusta” – tek lavdia përmes provave. Natyrisht unë dhe shumë të tjerë do të donim ta shihnim Kosovën të njihet në mënyrë të lavdishme nga të gjitha shtetet anëtare të KB-së, pasur nevojë të bartë më shumë prova në rrugën e gjatë dhe të ngushtë deri te njohja e plotë dhe shtetësia. Por fatkeqësisht nuk varet vetëm nga ne.

Fjala e urtë latine shprehë atë që është diskutuar në qarqet akademike si ‘dykuptimësi diplomatike’. Formulimet me dykuptimësi shfrytëzohen për ta mundësuar një shkallë të konsensusit kur palët që janë pjesë e bisedimeve nuk mund ta arrijnë një marrëveshje. Përmes dykuptimësisë zgjidhja përfundimtare mund të shtyhet për rrethana të ardhshme dhe duke shpresuar për rrethana më të mira, ndërsa në ndërkohë janë të mundur hapa të caktuar përpara. Kjo është vlera e këtij ylli dhe e fusnotës për Kosovën. Kjo marrëveshje i shtyn dallimet ende të pazgjidhshme, por e bën Kosovën pjesëmarrëse të plotë në bazë të aftësisë së saj në takimet dhe ngjarjet rajonale dhe do t’ia mundësojë përparimin e mëtejshëm në marrëdhëniet kontraktuese me BE-në. Kosova në këtë mënyrë do ta ndjekë kursin e njëjtë evropian si edhe të tjerët në Ballkanin Perëndimor, në pajtim me perspektivën e saj evropiane.

Prandaj, vlera e kësaj marrëveshjeje është që Kosova mund ta shfrytëzojë atë që thotë marrëveshja në lidhje me përfaqësimin dhe bashkëpunimin rajonal: Kosova do të marrë pjesë dhe do të nënshkruajë marrëveshje të reja në emër të vetin dhe do të flasë për vete në të gjitha takimet rajonale. Nuk ka UNMIK më! Nëse politikanët nga Serbia ose nga njëra prej pesë shteteve të BE-së që nuk e kanë njohur Kosovën kërkojnë që UNMIK-u të ulet afër përfaqësuesit të Kosovës, ose të flasë ose të nënshkruajë në emër të Kosovës, Kosova pa dyshim mund të thirret në këtë marrëveshje dhe

të kërkojë që ajo të respektohet. Kosova mund ta shfrytëzojë atë në CEFTA, në RCC ose në çdo lloj të ngjarjeve publike rajonale. Madje edhe në OSBE— e cila po ashtu është organizatë rajonale, edhe pse rajoni është natyrisht pak më i madh— ku deri tani në emër të Kosovës ka folur gjithmonë Shqipëria: është koha që këtë ulëse ta zënë vetë diplomatët e Kosovës.

E di që fusnota, sipas së cilës Kosova tani do të jetë në gjendje të marrë pjesë në emër të vetin, ka shkaktuar shumë kundërshtime në mesin e pjesëtarëve të opozitës dhe të shoqërisë civile në Prishtinë, duke e kujtuar supozimin e tyre që dialogu nga ana e BE-së kishte thjeshtë për qëllim t’ia sillte Serbisë statusin e kandidatit dhe duke pohuar që kjo fusnotë do ta zgjasë edhe më situatën e paqartë lidhur me statusin dhe nuk do ta çojë Kosovën përpara në rrugën e saj drejt Bashkimit Evropian. Unë e kuptoj që mund të paraqiten probleme në takimet ku në të kaluarën kosovarët përfaqësoheshin me flamurin e Kosovës dhe tani disa njerëz (serbë ose të tjerë) mund të pohojnë që ylli dhe fusnota janë të domosdoshme. Siç kam bërë tashmë në një shkrim në gazetën Koha Ditore të Prishtinës, unë sidoqoftë do t’i lusja qytetarët e Kosovës që ta marrin hapësinë publike të cilën ua jep marrëveshja e dialogut dhe ta shfrytëzojnë atë – që do të thotë se Kosova do të marrë pjesë, të flasë dhe të nënshkruajë në emër të vetin në organizatat rajonale – dhe ta interpretojnë në mënyrën e vet e jo në mënyrën si e interpreton atë Beogradi. T’i lejojnë serbët dhe të tjerët ta lënë



tavolinën nëse nuk pajtohen – por të rinë pranë tavolinës vetë. Për shembull, unë kam argumentuar, aplikimi për anëtarësim në OSBE, e cila mund të konsiderohet si „organizatë rajonale“, do të ishte i mundur për ta shfrytëzuar kornizën e gjerë interpretuese. Kosovarët po ashtu mund ta shfrytëzojnë raportin tim të fundit në Parlamentin Evropian dhe ta shfrytëzojnë mënyrën sipas së cilës ai qartë i referohet Kosovës si shtet i pavarur. Ky raport i fundit po ashtu kërkon që Serbia t’i zbatojë të gjitha për të cilat është pajtuar në dialog dhe që të pesë shtetet anëtare të BE-së ta njohin Kosovën.

Sidoqoftë, unë i pranoj kritikën e disave në Kosovë, dhe për më tepër i ndaj disa argumente — por t’i kthehem përsëri fjalës së urtë latine të përmendur më sipër: kjo është angusta, rruga e shkurtë dhe provat që ende duhet të tejkalohen — por nuk është një hap prapa, dhe pas një kohe të të punuarit, të marrjes me këtë marrëveshje dhe të jetuarit me të në diplomacinë e përditshme, jam e bindur që Kosova do të gjejë ca „augusta“, ca lavdi! Kjo nevojitet urgjentisht dhe është tepër e vonuar.

Krahasuar me ish - shtetet jugosllave të cilat i ndërtuan shtetet e tyre të reja në ish-strukturat administrative dhe të përvojave dhe të kontakteve jugosllave, Kosova është shumë prapa në pothuajse

çdo gjë: ekonomikisht, investimet janë të ulëta dhe papunësia (e të rinjve) shumë e madhe, kapaciteti në strukturat administrative është ende i ulët, për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në të gjitha nivelet nevojiten përpjekje më të fuqishme dhe rezultate. Kosova është prapa po ashtu edhe në lidhje me BE-në: qoftë liberalizimi i vizave (është vendi i vetëm i Ballkanit Perëndimor qytetarët e të cilit ende nuk mund të udhëtojnë pa viza në BE, ndërsa të gjitha të tjerat e kanë këtë të drejtë që nga fundi i vitit), ose qoftë në lidhje me marrëdhëniet kontraktuese me BE-në: drita e gjelbër për fillimin e bisedimeve për marrëveshje tregtare është dhënë tek në dhjetor 2011, tani Komisioni do ta hartojë një studim të fizibilitetit për Marrëveshjen për Stabilizim dhe Asociim. Është e kuptueshme që në mesin e qytetarëve të Kosovës ka zhgënjim dhe zemërim që katër vjet pas pavarësisë Kosova ende nuk është republikë e pavarur plotësisht e zhvilluar — dhe hyrja në BE është ende më larg se për vendet fqinje.

Shpesh ua kujtoj kosovarëve, të cilët nuk kanë durim, që vendi i tyre është shumë i ri, shteti më i ri evropian, dhe nevojitet kohë për ndërtimin e shtetit. Sidoqoftë, një pjesë e madhe e problemeve të Kosovës ekziston po ashtu për shkak të mungesës së përkushtimit dhe të unitetit të bashkësisë ndërkombëtare. Pesë shtete anëtare të BE-së ende nuk e kanë

njohur Kosovën dhe Kosova ende nuk është anëtare e plotë e Kombeve të Bashkuara (në kohën kur po e shkruaj këtë, 89 shtete e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, ende më pak se 50% të shteteve anëtare të KB).

Përveç pengesës që shkakton kjo për përpjekjet diplomatike në organizatat ndërkombëtare, ky është po ashtu aspekt frustrues për sportdashësit në Kosovë: deri tani, sportistët kosovarë nuk kanë mundur të marrin pjesë në ngjarjet sportive rajonale, lëre më në ato ndërkombëtare, për ta përfaqësuar vendin e tyre me flamurin e tyre. Vetëm një numër i vogël luajnë, për shembull, futboll në ekipet e popujve të tjerë, por ata nuk mund të marrin pjesë në turne për Kosovën. Si raportuese e Parlamentit Evropian për Kosovën, unë e shoh rolin tim po ashtu si avokate për qytetarët e këtij vendi më të ri evropian dhe kështu që ia shkrova një letër kryetarit të Komitetit Olimpik Ndërkombëtar (KON) Jacques Rogge dhe të gjithë anëtarëve të Bordit Ekzekutiv të KON-it, në të cilën kërkoja nga ata ta gjejnë një zgjidhje për sportistët dhe sportistët e Kosovës që të marrin pjesë në lojërat olimpike.

Në këtë letër unë e kam përmendur raportin tim për Kosovën, i cili është aprovuar më 29 mars nga pjesa më e madhe e Anëtarëve të Parlamentit Evropian (me 457 vota për, 97 vota kundër dhe 76 abstenime, kjo përbën shumicë më të madhe se në vitet e mëparshme), dhe i cili në paragrafin 50 thekson „rëndësinë për përmirësimin e marrëdhënieve dhe të përfaqësimit të Kosovës në kuadër të institucioneve ndërkombëtare kulturore dhe të trashëgimisë dhe në organizatat e sportit, duke e përmendur në veçanti Komitetin Olimpik Ndërkombëtar me qëllim që t’ua mundësojë sportistëve kosovarë të marrin pjesë në Lojërat e ardhshme Olimpike në Londër “. Në letrën time unë në mënyrë specifike kam ngritur çështjen e kampioness në xhudo Majlinda Kelmendit, e cila ka fituar mjaft pikë për të marrë pjesë në Londër — nëse e lejojnë.

Sa di unë, sporti, duke u bazuar në parimin e drejtësisë, mund ta luajë një rol



foto: Jetmir Idrizi

të rëndësishëm në të ndihmuarit e tejkalimit të armiqësive nga e kaluara dhe të paragjyqimeve ndërmjet popujve dhe vendeve. Një shembull shumë i mirë për këtë është nisma e KON-it për bashkëpunim më të mirë ndërmjet Komiteteve Olimpikë nga Izraeli dhe Palestina. Jam e bindur që sporti do të mund të luante një rol shumë të dobishëm në procesin e pajtimit në Ballkanin Perëndimor në përgjithësi dhe në procesin e dialogut ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, në veçanti, sikur KON-i të vepronte në mënyrë të ngjashme në Ballkanin Perëndimor dhe t’ia lejonte Kosovës të jetë pjesë e familjes olimpikë— në pak a shumë të njëjtën mënyrë si në rastin e sportistëve palestinezë të cilët, edhe pse Palestina është edhe më larg nga të qenit e shtet i njohur nga KB-ja si Kosova, tashmë kanë marrë pjesë disa herë, madje edhe nën flamurin e Palestinës. Ekziston një shembull tjetër: më 1992, deri sa ishin në fuqi sanksionet e KB kundër regjimit të

Milloseviqit, sportistët serbë dhe malazezë morën pjesë si sportistë të pavarur me flamurin olimpik. Kjo, së paku, duhet po ashtu t’i mundësohet Majlinda Kelmendit dhe kolegëve të saj për lojërat në Londër. Para së gjithash për arsye se, ashtu siç ka thënë themeluesi Baron de Coubertin, parimi udhëheqës i lojërave bashkëkohore olimpikë thotë „gjëja më e rëndësishme në lojërat olimpikë nuk është fitorja por pjesëmarrja, ashtu sikurse gjëja më e rëndësishme në jetë nuk është ngadhënjimi por lufta.” (Në kohën kur po e shkruaj këtë artikull ende nuk kam marrë ndonjë përgjigje nga KON-i.)

Rëndësia e të përpjekurit gjer sa të gjendet një zgjidhje më sjellë tek tema e Kosovës * dhe e fusnotës. Siç e përmenda më herët, nuk pajtohem me zërat që flasin për një kthim pas lidhur me marrëveshjen për fusnotën. Kur të shikohet formulimi, ‘në pajtim me’ i referohet kronologjisë së ngjarjeve:

Rezoluta 1244 e KSKB, e aprovuar 13 vjet më parë, ende nuk është zëvendësuar me ndonjë Rezolutë të re të Këshillit të Sigurimit. Ky është fakt, për shkak të Rusisë dhe Kinës dhe strukturës së luftës së ftohtë në Këshillin e Sigurimit të KB, pesë anëtarët e përhershëm të të cilit kanë të drejtën e vetos. Fusnota fillon me 1244, por përfundon duke e përmendur mendimin e GJND-së të korrikut 2010 për Shpalljen e Pavarësisë së Kosovës – e cila, siç e din edhe Beogradi, ka theksuar që shpallja e pavarësisë nuk ka qenë në kundërshtim me të drejtën ndër-kombëtare.

Dhe po, ekziston një e ardhme e ndritur për këtë asterisk (yll), ashtu siç ka propozuar Fondacioni Kosovar për Shoqëri të hapur në propozimin e tij për titull të këtij artikulli: marrëveshja e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë më 24 shkurt 2012 ka përfshirë Menaxhimin e Integruar të Kufijve, MIK. Marrëveshja MIK është marrëveshja e parë bilaterale ndërmjet Kosovës dhe

Serbisë – de facto kjo nënkupton njohje të shtetësisë së Kosovës. Qeveria serbe mund ta mohojë atë aq shpesh sa të dëshirojë dhe prapë se prapë mund ta refuzojë nënshkrimin e MIK, por të gjithë e dinë që ky është një fakt. Përkrahësit e Serbisë në BE po irritohen gjithnjë e më tepër me refuzimin e Serbisë që ta nënshkruajë dhe ta zbatojë këtë marrëveshje dhe marrëveshjet e tjera. Fakti që MIK ekziston— dhe Serbia do të duhet ta respektojë atë— do të ketë ndikim pozitiv tek të tjerët për ta njohur Kosovën. Duke e pasur parasysh që Serbia po i pranon marrëveshjet bilaterale me Kosovën, pse mos ta pranojnë pesë shtetet e BE-së që nuk e kanë njohur Kosovën dhe të tjerët që është koha që edhe ata të ecin përpara? Megjithatë, mbetet kërkesë që të 22 shtetet anëtare të BE-së që e kanë njohur Kosovën të bëjnë presion dhe t'i bindin pesë të tjerat të mbetura që ta bëjnë këtë po ashtu.

Stefan Füle, Komisari Evropian për Zgjerim dhe Fqinjësi Evropiane, ka rikonfirmuar fuqishëm përkushtimin e BE-së që Kosovës t'i ofrojë një perspektivë evropiane kur foli në takimin ndërparlamentar PE-Kosovë në mars 2012: „Komisioni është plotësisht i angazhuar me Kosovën. 2012 është viti ynë i mundësisë. Të punojmë së bashku për ta shndërruar këtë mundësi në realitet.”

Jam thellësisht e bindur që 2012 është vit i mundësisë për Kosovën. Pa dyshim, njëherë e përgjithmonë duhet të përfundojë koha për humbje kot të energjisë, kohës dhe parave për shkak të 'neutralitetit ndaj statusit' më tepër se katër vjet pas shpalljes së pavarësisë: EULEX-i, misioni më i madh civil i Bashkimit Evropian ende duhet ta mbajë "neutralitetin ndaj statusit" dhe prandaj nuk mund ta kryejë misionin e tij të plotë për të cilin është krijuar (aktualisht për shembull gjyqtarët vendosin vetë cili ligj zbatohet – ligji ish-jugosllav, ligji i UNMIK-ut, ose ligji i Kosovës; sqarimi mund të gjendet vetëm nëse ekziston vullneti politik për të qëndruar vendosmërisht pas Kosovës si shtet. Kjo gjendje ka krijuar probleme të natyrave

të ndryshme dhe do të vazhdojë të krijojë edhe më tepër probleme nëse mandati nuk ndryshon në përputhje me rrethanat).

Situatat e rrezikshme në Veri të Kosovës, e cila kërcënon jetesën e qytetarëve, duhet të përfundojë. Serbia duhet ta ndalë mbështetjen e saj jo-transparente të strukturave paralele serbe në Kosovë, për më tepër qeveria e Kosovës duhet t'iu afrohet serbëve në veri dhe t'i përfitojë ata me një pako që shfrytëzon përmbajtjen e planit të Ahtisaarit: një autonomi të gjerë për katër komunat, mbështetje transparente nga Beogradi, por në kuadër të juridiksionit dhe të territorit të republikës së pavarur të Kosovës.

Pjesa më rënduese e "ngecjes diplomatike" brenda BE-së e krijuar nga pesë shtetet mos-njohëse është që ata nuk përmbahen nga njohja për shkak të shqetësimeve për serbët në Kosovë ose për Serbinë. Ato shtiren që janë të shqetësuara për shkeljen e të drejtës ndërkombëtare – dhe nuk dëshirojnë ta kuptojnë që GJND më 2010 ka vendosur që shpallja e pavarësisë nuk ishte në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare.

Në të vërtetë, janë lojërat politike vendase dhe frika nga pakicat etnike në vendet e tyre që kërkojnë pavarësi që i pengojnë ato ta njohin Kosovën – baskët dhe katallanët në Spanjë, hungarezët në Rumani dhe Sllovaki, dhe për Qipron dhe Greqinë për shkak të okupimit të Qipros Veriore nga ana e Turqisë. Por duke mos e njohur Kosovën, të pestat pa dyshim krahasojnë veprimet e qeverive të tyre ndaj pakicave etnike me diktaturën e Millosheviqit. Kjo është qesharake, duke e pasur parasysh që asnjëra prej qeverive të zgjedhura në mënyrë demokratike të këtyre vendeve nuk kanë urdhëruar ndonjëherë apo nuk kanë zbatuar spastrim etnik ashtu siç ka bërë Millosheviqi kundër shqiptarëve të Kosovës.

Na nevojiten udhëheqës të guximshëm – në Serbi dhe në Kosovë, por po ashtu në pesë anëtarët mos-njohëse, të cilët e

përfundojnë këtë tregim të trishtuar të mosnjohjes që i mbanë qytetarët e Kosovës në gjendje harrese dhe krijojnë edhe më shumë pakënaqësi se sa që shkaktojnë problemet ekonomike dhe sociale. Është koha të fillojë puna e plotë në çështjet themelore siç janë sundimi i ligjit, drejtësia sociale, zhvillimi ekonomik dhe ndërtimi i shtetit— dhe të mos lejohet që gjendja e harresës t'iu japë arsyetim autoriteteve të Kosovës për mosveprimin e tyre efektiv dhe të përshtatshëm.

Nëse ne në BE që besojmë në të ardhmen e të gjitha shteteve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian, sepse ai është premtimi dhe bindja jonë për projektin paqësor evropian, madje edhe në kohë të krizave ekonomike dhe të borxhit, nëse nuk jemi në gjendje t'i ndryshojmë këto fakte, atëherë ne rrezikojmë jo vetëm ta humbim Kosovën dhe qytetarët e saj, por po ashtu edhe popullin e disa prej shteteve të tjera në rajon. 'Bashkëpunim në vend të konfrontimit' është parimi kryesor mbi të cilin është ndërtuar Bashkimi Evropian. Ky parim, nëse zbatohet si duhet, mund ta bëjë Ballkanin Perëndimor një pjesë të integruar plotësisht në BE. Dhe ylli i Kosovës do të jetë një hap drejt kësaj të ardhmeje të ndritshme evropiane – ose si do të thoshte Asteriksi, „Ad augusta per angusta!”

(Ulrike Lunaçek është anëtare e Parlamentit Evropian nga Austria për grupin Greens/EFA që nga viti 2009. Ajo është zëdhënëse për çështje të jashtme e grupit të saj dhe raportuese e Parlamentit Evropian për Kosovën. Nga viti 1999 deri më 2009 Lunaçek ishte anëtare e Parlamentit Austriak për të Gjellbrit. Ajo ka diplomë të universitetit në interpretim (Anglisht-Spanjisht-Gjermanisht) dhe para se t'i bashkohej Partisë së të Gjellbërve ka punuar në zhvillimin e OJQ-ve dhe si gazetarë dhe përkthyes. Lunaçek po ashtu ka qenë aktiviste në lëvizjen Bota e Tretë, në atë feministe dhe në atë LGBT.)

NEGOCIATAT: NJË RAST I HUMBUR

Veton Surroi
maj 2012



Kosova dhe Serbia kanë negociuar prej marsit të vitit 2012 deri në shkurt të vitit 2013, me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian.

Nëse u besohet në tërësi të gjithë pjesëmarrësve në këtë proces, pra palës kosovare, asaj të Serbisë dhe ndërmjetësit ndërkombëtar, të gjithë kanë fituar. Qytetarët e të dyja vendeve kanë fituar, sepse kanë më shumë liri qarkullimi, dikur do të mund të kenë qasje në dokumentet kadastrale e gjëra të tjera. Për më tepër, në sajë të këtij procesi negociator, Serbia e ka fituar statusin e kandidatit për aderim në Bashkimin Evropian, ndërsa Kosova, sipas premtimeve, do të mund të fillojë eventualisht procesin e Stabilizim-Asociimit, pasi të kalojë skanimin detaj nga ana e Komisionit Evropian dhe do të mund të fillojë procesin e liberalizimit të vizave, pasi të marrë udhërrëfyesin për këtë veprim nga ana e Komisionit Evropian.

Shërbimi për veprim të jashtëm i BE-së, një lloj pararendësi i Ministrisë së Jashtme të BE-së, mund po ashtu të shënojë si fitore të veten ndërmjetësimin e suksesshëm mes Serbisë e Kosovës, duke përmbyllur detyrën e marrë në Asambleenë e përgjithshme të OKB-së, në tetor të vitit 2010.

Menjëherë në të përmbyllur ky proces negociator, i quajtur "dialog teknik", dhe në të përshëndetur çdo njëri arritjet e mëdha në të, në diskursin diplomatik evropian doli në sipërfaqe nevoja që Kosova dhe Serbia të fillojnë, pas zgjedhjeve presidenciale dhe parlamen-

tare në Serbi, një proces të ri negociator, tashmë "politik", i cili duhet të shërbejë për të normalizuar marrëdhëniet mes Kosovës dhe Serbisë.

Nëse paska nevojë për një proces të ri negociator, atëherë ky i kaluari ka një deficit. Deficiti i tij është se nuk ka arritur të normalizojë marrëdhëniet mes dy shteteve. E, kështu do të duhej të interpretohej thirrja e Asamblesë së përgjithshme të OKB-së në tetor të vitit 2010 për dialog mes Prishtinës dhe Beogradit.

Në fakt, ka qenë përlllogaritje e gabuar. As Beogradi, as Brukseli, e as Prishtina, në fund, nuk e kanë parë procesin negociator (bile e kanë quajtur "dialog", për t'i ikur konotacioneve politike.) si një mjet për normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë. Serbia e ka parë si proces me të cilin do t'i krijojë vetes kushtet për të fituar statusin e kandidatit për anëtarësim në BE e ndërmjetësi në Bruksel po ashtu. Elitat qeveritare në Prishtinë, me gjasë, e ka parë si mjet për të ndryshuar pamjen e tyre individuale e të Kosovës, pas një sërë titujsh negativ për Kosovën në botë: raporti i Dick Martyt për trafik organesh, keqpërdorim masovik i zgjedhjeve parlamentare, zgjedhja e një figure jo të ndritshme për president vendi në rrethana larg një standardi ligjor e demokratik.

Rezultati është se Serbia vazhdon ta kontestojë jo vetëm pavarësinë e Kosovës (me mosnjohje, me pengim legjitimitetit ndërkombëtar të vendit), por edhe tërësinë tokësore të Kosovës dhe

funksionimin e institucioneve të saja.

Mund të thuhet se propë jemi në të njëjtën gjendje si para fillimit të negociatave, por kjo nuk do të ishte e vërtetë.

Negociatat e kaluara ("dialogu"), kanë prodhuar disa rezultate me të cilat Prishtina, në radhë të parë, e pastaj edhe aktorët tjerë në këtë përpjekje, do të merren në të ardhmen.

Rezultati i parë i këtij procesi është se i ka munguar procedura. Në fund të tij, asnjëra palë nuk ka dalë me dokument të nënshkruar, i cili e obligon, nga njëra anë, dhe e shndërron në palë karshi palës tjetër. Për Prishtinën zyrtare kjo do të thotë se edhe marrëveshjet kaq të pakta të arritura, mund të bëhen sërish objekt riinterpretimi dhe negocimi, për shkak se Serbia nuk e respekton në këtë apo atë aspekt. Kësi soji, Kosova do të shpenzojë energji të kotë, së bashku me Brukselin, për t'u marrë me çështje që do të duhej të konsideroheshin si të negociuara. Shembull eklatant është menaxhimi i integruar i kufijve (apo i pikë-kalimeve, siç do ta quajë Serbia). Kjo marrëveshje ende nuk zbatohet, dhe do të vazhdojë të jetë objekt riinterpretimi për një arsye fundamentalisht të thjeshtë: vija që ndan Serbinë prej Kosovës ende trajtohet në formë diametralisht të kundërt mes dy shteteve. Dhe, në vend të negociimit të një forme me të cilën të dy palët do ta trajtonin këtë vijë në formë tranzitore, "dialogu teknik" prodhoi një trik semantik, me të cilin ajo që në BE njihet në versionin anglisht si Menaxhim i integruar i kufijve do të mund të quhej



ndryshe përkthyer shqip e ndryshe në serbisht.

Natyrisht, një marrëveshje më ambicioze që e pamundur ngase në procesin e "dialogut teknik" ka munguar legjitimi i drejtpërdrejtë i Qeverisë së Kosovës si palë e identifikuar de jure nga Qeveria e Serbisë, procesi i ardhshëm negociator mund të konsumojë energji për ta definuar mu këtë.

Rezultati i parë: pala kosovare nuk i ka bërë detyrat elementare të shtëpisë, duke mos kërkuar definimin e procedurës, dhe duhet ta bëjë në procesin e ardhshëm negociator.

Rezultati i dytë i këtij procesi, rrjedhimisht, është se ka munguar forma. Në vend të një negociate që do të përcaktonte parimet udhëheqëse e të panegociueshme për të dyja palët, formatin e negociatorëve, cakun e përbashkët e procesit negociator që në fund do të ishte detyrimisht përshkrimi i gjendjes së "normalizimit", të pranuar nga të tria palët, Kosova ka pranuar gjatë vitit të fundit të hyjë në një proces krejtësisht të paqartë nga aspekti i parimeve.

Ky proces është mbështetur mbi ndërtimin e parimeve në sajë të marrëveshjeve të arritura, njëra pas tjetres. Dhe, në sajë të kësaj qasje, Kosova tashmë ka krijuar disa precedentë të pavolitshëm për të në negociatat e ardhshme.

Të përmend vetëm dy. Fillimisht, Kosova ka pranuar bashkëpërgjegjësinë shtetërore për vendin me Serbinë, duke

pranuar që Serbia të mbajë origjinalet e dokumentacionit civil të Kosovës (regjistrat kadastral dhe librat amzë) e që Kosovës t'ia dorëzojë kopjet. Në çfarëdo negociate të ardhshme, Serbia mund të citojë këtë precedentë gjatë adresimit të çështjeve të tjera. Kështu, Beogradi fare lehtë mund të kërkojë që të ketë bashkëqeverisje (pra, përgjegjësi e përbashkët administrative) në pjesën e vendit në veri të lumit Ibër.

Së dyti, negociatorët kosovarë, e pastaj dhe Qeveria, kanë pranuar, nëpërmjet të fusnotës së famshme me të cilën Kosova paraqitet në takimet rajonale, që statusi i Kosovës jo vetëm që është i kontestuar (gjë që e di e tërë bota), por që është edhe i kontestueshëm (pozicion ky i Serbisë dhe i përkrahësve të saj). Sepse, një gjë është që Serbia e të tjerët të kërkojnë që ta përshkruajnë Kosovën si vend që ende administrohet me Rezolutën 1244 të KS të OKB, e krejt tjetër që këtë ta pranojë edhe Kosova, pra vendi i cili supozohet se me Deklaratën e vet të pavarësisë tashmë e ka konsumuar pjesën e Rezolutës që ka të bëjë me përcaktimin e statusit përfundimtar.

Me këso precedentë, Kosova do të hyjë në procesin e ardhshëm negociator, duke mos mundur të ndikojë më seriozisht në parimet udhëheqëse: ajo tashmë ka pranuar se parim udhëheqës i negociatave të ardhshme është se statusi i Kosovës është i hapur për diskutim.

Për më tepër, do të hyjë në një proces negociator kur edhe vet Bashkimi evropian ka krijuar një precedent të

vetin. Duke ia dhënë statusin e kandidatit Serbisë, në momentin kur u dëshmuar se strukturat paralele në Veri, të financuara nga Serbia, e përdorin edhe forcën kundër NATO-s, EULEX-it dhe institucioneve shtetërore të Kosovës, Bashkimi Evropian e uli pragun e vet të tolerancës deri në zbehje të plotë. Strukturat paralele serbe në Veri tash do të trajtohen si një realitet i legjitimuar, një realitet i cili nuk trajtohet si diçka që do hequr me automatizmin e zbatimit të ligjit, por një realitet që do proces të gjatë negociator.

Pas mendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, në korrik të vitit 2010, Kosova, Serbia dhe Bashkimi Evropian kishin një rast shumë të mirë për ta vendosur një binar normalizimi marrëdhëniesh mes Serbisë dhe Kosovës, mu brenda kontekstit të integritetit evropian. Në vend të këtyre binarëve, u krijua një proces i çoroditur që e ka ngritur Serbinë në një format tjetër të marrëdhënies me BE-në, atë të kandidatit për anëtarësim, e Kosovën e ka mbajtur në format krejtësisht të njëjtë, në parhyrje të diskutueshme për çdo gjë, përfshirë edhe studimin e fizibilitetit për procesin e Stabilizim asociimit.

Në një këso konteksti, nuk është e vështirë që të parashikohet, në vija të trasha, një proces i ardhshëm negociator, që ka për qëllim vendosjen e një statusi special për Veriun e Kosovës. Në një këso negociate, Serbia do të fitonte, pos statusit special, edhe datën e fillimit të negociatave për anëtarësim në BE e Kosova do të fitonte "perspektivën evropiane", studimin e fizibilitetit për MSA, udhërrëfyesin për viza dhe një fotografi të kryeministrit me Baroneshën Ashton.

Tingëllon si tashmë e përjetuar? Po, sikur edhe fjalët që do të dilnin pas kësaj marrëveshjeje: Serbia dhe Kosova prapë duhet të zhvillojnë negociatat politike, të nivelit të lartë. Tashmë për të trajtuar diferencat e tyre rreth statusit të Kosovës, pavarësinë e së cilës Serbia nuk e njeh.

ORA E DIPLOMACISË PRISHTINASE...

Eliza Hoxha

dhjetor 2012



Përtej rolit si kryeqendër e Kosovës në shërbim të të gjithëve, që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës -Prishtina ka dhe një detyrë tjetër që i vjen përpara, atë të diplomacisë, reprezentimit të shtetit, përmirësimit apo edhe konstruktimit të imazhit të saj dhe njohjeve të reja. Përtej imazhit vetjak që Prishtina duhet ta shfaq përpara botës, përmes saj copëza të tjera imazhesh dhe vlerash nga pjesë e qytete të ndryshme të Kosovës duhet të përmbledhen në mozaikun e përgjithshëm i cili do ta brand-oj Kosovën në të ardhmen.

Në këtë kontekst gjithmonë na vijnë përpara disa pyetje qensore:

- Cilat janë vlerat unike të Kosovës, apo me çfarë mund të identifikohet ajo në botë?
- Cili është imazhi apo fytyra e

kryeqendrës së Kosovës përpara botës?


- Sa është e rëndësishme diplomacia publike dhe njëkohësisht format e reja të diplomacisë si ajo sociale dhe kulturore?
- Kush janë njerëzit apo dhe përfaqësuesit nga sferat e ndryshme civile të cilët mund të jenë pjesë e procesit të brandingut të Kosovës përtej diplomacisë zyrtare – publike?

- Si brand-ohet Kosova dhe çfarë e dallon branding-un nga marketingu?

Këto janë vetëm disa nga pyetjet e shumta që pata rastin ti shtjellojë bashkë me një grup vajzash kosovare si pjesë e programit Hope Fellowships - korniza "Diplomaci dhe Demokraci" të organizuar nga Këshilli Kombëtar Shqiptarë – Amerikan dhe të përkrahur nga USAID për 6-javë në Washington DC.

Për herë të parë termi "nation branding" apo branding-u i kombit "është përdorur në vitin 1990 nga Simon Anholt si një mundësi e aplikimit të strategjive të marketingut për promovimin apo krijimin e imazhit të shteteve në veçanti".

Në këtë kontekst Kosova veç sa ka filluar të shfaqet dhe përtej një imazhi të luftës, konfliktit, korrupsionit dhe ndodhive të tjera negative për të cilat ajo ka qenë në qendër të vëmendjes ndër vite, tani duhet të filloj konstruktimin e një imazhi pozitiv por gjithherë të bazuar në vlerat e vërteta, në përmbajtje dhe në atë çfarë e bënë unike Kosovën si shtet. Në këtë rrugëtim rreziku është mjaft i madh që përtej një branding-u real dhe njëkohësisht vizionar, procesi të shndërrohet në një fushatë të tipit "ëish list" apo projeksion se si kishim dashur Kosova të jetë.



Ky lloj imazhi sipërfaqësor sado joshës, atraktiv dhe i bukur të jetë është jetë shkurtër dhe shpesh edhe mund të na kthehet boomerang.

T'i përmendim vetëm disa aktivitete të cilat Kosovës i kushtuan shumë para, përderisa ndikimi në përmirësimin e imazhit nuk ishte ai i prituri. Një nga vlerat për të cilat përmendet Kosova është popullata e re në moshë, e cila mund të shihet si aset por që njëkohësisht në një kontekst me ekonomi jo shumë të zhvilluar çfarë është Kosova ky aset mund të shndërrohet në barrë apo problem. Kujtojmë fushatën e të rinjve "young Europeans" e cila përtej disa fytyrave të reja, të njoma të bukura dhe të veshura me shije, la shumë për të dëshiruar. Dikush mund të pyes përse? Është fare e thjeshtë. Kush janë këta të rinj me të cilët ne përfaqësohemi, çfarë vlere dhe titullari paraqesin ata për Kosovën përbrenda, përtej faktit të të qenit të ri në moshë. Çfarë i bënë ata të jenë "role model" për të rinjtë e tjerë kosovar dhe çfarë i shquan ata të jenë fytyra e Kosovës që duhet të perceptohet nga jashtë. Përgjigjet janë fare të thjeshta.

Përtej imazhit duhet të fshihet përmbajtja e cila e bënë gjithë Brandin të besueshëm dhe me vlerë.

Në krejt këtë proces, sado të rinj që jemi ka disa pyetje të cilave duhet të mundohemi t'u japim përgjigje... A e dinë

qytetarët e Kosovës se çfarë nënkupton "Nation Branding", pse bëhet dhe për çfarë shërben ai.

Disa edhe e dinë sigurisht, ngase ka njerëz të shumtë nga bota e artit e kulturës dhe jo vetëm, që shpesh në mënyrë vetjake bëjnë shumë më shumë në përmirësimin apo krijimin e imazhit ndryshe të një shteti, aty ku diplomacia tradicionale edhe mund të ketë ngërçe apo ngecje. Ata njerëz sot gjithandej nëpër botë legjitimohen si "ushtria" e diplomacisë sociale apo kulturore, duke qenë njerëz me bagazh, personalitete me peshë publike në vendin ku përkasin apo prej nga vijnë. Dhe, nuk thonë kot se aty ku diplomacia tradicionale dështon, llojet e tjera të diplomacisë vijnë në shprehje si procese nga poshtë – lartë dhe që në mënyrë më të sofistikuar ndikojnë në imazhin e një shteti.

Në këtë kontekst, atë që diplomacia tradicionale po mundohet ta bëjë tash e katër vite, këngëtarja Kosovare Rita Ora e bëri vetëm më një hap. Ajo zgjodhi që Prishtinën ta sjell në sytë e botës dhe ti jap shkëlqimin e saj prej ylli që ka filluar të shndrit ndër kombëtarisht. Gjithë energjia e të rinjve, gjithë brishtësia e një shteti "NEWBORN", gjithë përplasjet dhe gërshetimet midis të resë dhe të vjetrës, rrugëve me kalldrëm dhe motoristëve cool, u bënë pjesë e videos

së këngës "Shine your light" me një qëllim të vetëm, për ti dhënë një dritë të re dhe një imazh të ri Kosovës.

Ora e bëri diplomacinë e saj e cila Prishtinës nuk i kushtoi me asnjë cent të vetëm, por që e vuri atë si pikë referente në rrjetin e komunikimit global muzikor. Dhe, përtej nderit që Ora i bëri Prishtinës dhe tërë Kosovës, mendoj se Prishtinës i ka ardhur Ora që të filloi ti legjitimoj edhe shumë pjesëtar të "ushtrisë" së diplomacisë sociale/kulturore që veprojnë përbrenda në tërë Kosovën. Por që, fillimisht për gjithë këtë nder të Orës, Kosova duhet të nis duke e nderuar dhe legjitimuar Orën si një ambasadore të kulturës Kosovare në botë.

Në këtë formë, kur fytyrat e reja, të bukura e shndritëse të Kosovës përfaqësojnë përmbajtje dhe vlere universale, Kosova nuk do të jetë më përjashtim nga paleta globale. Në të kundërtën joshja vizuale si komunikim i parë do të jetë vetëm karta e parë për mirëseardhje në Kosovën me vlerat e saj të vërteta.

Në këtë rrugëtim duke qenë të singertë me veten dhe me përzgjedhjen e përfaqësuesve tonë diplomatik, të tjerët do të fillojnë të reflektojnë singërisht, me dashamirësi dhe besueshmëri për Kosovën.

Prandaj, është koha e duhur që Prishtina/Kosova të nis ta ndjek Orën e diplomacisë shumë dimensionale për një imazh ndryshe.

Rita e bëri! Po ne?

Çfarë po bëjmë ne apo ndoshta çfarë mund të bëjmë ne? Kjo është pyetja e parë që duhet të ia bëjmë vetes sonë të gjithë çdo ditë. Çfarë kemi bërë ne për shtetin para se të kërkojmë diçka prej tij. Secili nga ne, kush në pikturë, kush në muzikë, kush në fizikë, e kush në letërsi, kush në informatikë e kush në politikë nëse japim më të mirën për vendin tonë, ai do të filloi natyrshëm të duket ndryshe, të frymoj ndryshe dhe të ketë kuptim për ne.

Ai do të piqu natyrshëm për të na i dhënë prapa frytet e tij dhe për të na shërbyer mirë, vetëm nëse ne i shërbejmë çdo ditë në të mirë atij. Pikënisja është fare e thjeshtë.

Së pari duhet të fillojmë ta duam vendin tonë, vërtet!







Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo
Kosovo Foundation for Open Society